

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

Raport i vitit 2020

1. QËLLIMI	3
2. OBJEKTIVI	3
3. STRUKTURAT ORGANIZATIVE.....	3
4. BAZË LIGJORE	4
5. ECURIA 2020.....	4
KAPITULLI I	5
6.1 Reforma e Decentralizimit në Shqipëri	5
6.2 Veprimtaria e Këshillit Konsultativ.....	6
KAPITULLI II	13
7.1 Mbeshtetja e Bashkive.....	13
7.2 Tërmeti.....	15
7.3 Pandemia	16
KAPITULLI III	21
8.1 Integrimi Evropian dhe përmbushja e detyrimeve sipas Marrëveshjes financiare IPA 2020	21
8.2 Diaspora	22
8.3 Projekti STAR.....	23
8.4 Projekti Bashkitë për në Evropë.....	23
8.5 Projekti Bashkite e Forta	25
8.6 Projekti; Situata ekonomike, strukturore dhe buxhetore të ndikuara nga pandemia COVID-19 për 13 bashki në Shqipëri	31
8.7 Konkursi i Praktikavete Mira	33
ANEKS 1.....	39

1. Qëllimi

Agjencia ka si qëllim mundësimin e zbatimit të reformës administrativo-territoriale, nëpërmjet bashkërendimit të të gjitha masave, proceseve dhe mbështetjes administrative deri në arritjen e funksionalitetit të plotë të 61 bashkive të reja. Agjencia ka si mision dhënien e ndihmës për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

2. Objektivi

1. Përbushja e detyrave dhe funksioneve sipas VKM nr.83, datë
2. Përbushja e detyrimeve për Integrimin Evropian, sipas prioriteteve të MB.
 1. Rishikimi i Kuadrit strategjik.
 2. Konsolidimi i Strukturave të Integritimit Evropian për Kapitullin 24
 3. Harmonizimi i legjislacionit Shqiptar me atë të BE-së dhe zbatimin e tijë.
 4. Forcimi i Bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të përbushjes së prioriteteve.

3. Strukturat Organizative

Organigrama dhe struktura e AMVV përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit nr.68, datë 05.05.2015 dhe 82, datë 12.05.2016, “Për miratimin e strukturës së Agjencisë së zbatimit të Reformës Territoriale”, pra që nga muaji Maj 2016 e në vazhdim për vitet 2017, 2018 dhe 2019 dhe 2020 organika e AMVV-së, aktualisht përbëhet nga 14 punonjës me kohë të plotë dhe 1 punonjës me kontratë provizore (1 sanitare me orar të reduktuar 6 orë). Organigrama e AMVV-së është e ndarë në 2 sektorë:

1. Sektori i Koordinimit me Qeverisjen Vendore;
2. Sektori i Analizës dhe Mbështetjes Institucionale.

Sektori i Koordinimit me Qeverisjen Vendore, përbëhet nga 1 përgjegjës sektori, 7 inspektorë. Ky sektor kryen detyrat e ngarkuara nga:

- 1- VKM 83 dt 28.01.2015 ndryshuar me VKM 11 dt.12.01.2018
- 2- Prioritetet e Ministrisë së Brendshme (MB) në fushën e pushtetit vendor
- 3- Çdo detyrë tjetër ngarkuar nga Ministri i Brendshëm apo Drejtori i Përgjithshëm.

Sa më sipër, drejtimet kryesore të punës për vitin 2020 janë si më poshtë.

- Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SKNDQV);
- Propozim për akte ligjore e nën/ligjore në zbatim të SKNDQV (Matrica e Kompetencave të NJVV-ve) dhe urdhri i Kryeministrit
- Propozime për krijimin e një sistemi unik për zbatimin e funksioneve të decentralizuara; One stop Shop 59 bashki tashme e kanë këtë shërbim , por duhet te jete aktiv dhe te jete i hapur nga ana personelit te bashkive.
- Koordinon punën midis institucioneve qendrore në funksion të përmirësimit të kuadrit ligjor të funksioneve të ushtruara nga pushteti vendor, nën cilësinë e Sekretariat Teknik për Këshillin Konsultativ; raporti për këshillin
- Bashkërendon punën e strukturave përkatëse për përbushjen e detyrave në kuadër të integritimit në BE (bashkërendim me Njësitë e Integritimit Evropian dhe monitorim vjetor

të zbatimit të detyrimeve të tyre në kuadër të integritit në BE); Raporti i performances se vitit 2019.

- Bashkërendon punën e projekteve qeveritare apo edhe në bashkëpunim me donatorët dhe institucionet e përfshira për përmirësimin e mëtejshëm të qeverisjes në nivel vendor; BPE, Star2, Bashki te forta, Flag, OSBE. LNB Etj.
- Informon, raporton dhe mbështet Ministrin e Brendshëm për problematikat e NJVV, sipas detyrave të përcaktuara dhe prioritet e Ministrisë së Brendshme lidhur me pushtetin vendor.
- Ka koordinuar me NJVV menaxhimin e situatës së Tërmetit dhe Pandemisë Covid 19 gjatë gjithë vitit ushtrimor.

Bazuar në prioritetet e Ministrisë së Brendshme për vitin 2020, AMVV si të gjitha institucionet e varësisë i ka ndjekur dhe i zbatuar ato në të gjithë veprimtarinë e saj institucionale.

4. Bazë Ligjore

Baza ligjore kryesore e funksionimit të AMVV është si më poshtë vijon:

Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Ligji 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

Ligji 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”

VKM nr. 83, datë 28.01.2015, “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar.

VKM nr. 910, datë 21.12.2016 “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

VKM nr.450, datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të Integritit Evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore”, etj.

5. Ecuria 2020

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore gjatë vitit 2020 pati vështirësi të shumta në realizimin e prioriteteve dhe detyrave të sajë si rezultat i fenomeneve natyrore të pa parashikuara, si ajo tërmetit të datës 26.11.2019, i cila vazhdon dhe sot me ndikimin negativ të dhënë në të gjithë vendin, si dhe e pandemisë Covid-19 e cila paralizoi lëvizjen e lirë dhe ngriu përkohësisht ekonominë e vendit.

Gjatë kohës së Tërmetit Agjenci u përfshi në të gjithë armatën e ngritur nga KNEC për ti ardhur në ndihmë qytetarëve të prekur nga ky fenomen natyror si; me grupet e vlerësimit të dëmeve në qarkun e Lezhës dhe si sektor mbështetjeje për KMC qarku Lezhë. Gjithashtu në qarkun e Durrësit u përfshi me ndihmën konkrete të dhënë nga grupet e ndihmës me ushqime dhe materiale të nevojshme. Në vlerësimin përfundimtar të dëmeve të kryer me asistencën e ekspertëve ndërkombëtar, Agjencia u përfshi në sektorin e DRR, mbi vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore me tre inspektorë. Ky vlerësim mori mbështetjen maksimale në konferencën e donatorëve të datës 27.02.2020.

Pa përfunduar gjendja e fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga tërmeti i 26.11.2020, pandemia globale Covid-19 u shtri dhe në Shqipëri. Agjencia u caktua në asistencë të kryetarit të KMC të qarkut Shkodër zëvendës Ministrit të Brendshëm deri në emërimin e prefektit të këtij qarku për një periudhë 2.5 muaj. Rivendosja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe dalja e akteve

normative mbi oraret e lëvizjeve dhe kategorizimin e grupeve të biznesit të cilat nuk mund të operonin lirshëm, krijoi vështirësitë e sajë dhe në realizimin e planit të përgjithshëm të punës së Agjencisë. Tashmë fokus ishte ngritja e strukturave dhe infrastrukturës vendore në të gjithë territorin e Shqipërisë për tu ardhur në ndihme qytetareve të izoluar nga pandemia. Agjencia u bë pjesë operative duke shërbyer si pjesë e sekretariatit teknik të ngritur me urdhër të drejtuesve të KNEC për tu ardhur në ndihme qytetarëve. Shumë shpejt u ngrit një sistem kombëtar koordinimi ku analizohej çdo kërkesë e qytetarëve si dhe rakordohej me AKEC dhe grupet e ndihmës të krijuara pranë çdo Njësie të qeverisjes Vendore si dhe çdo njësie administrative e deri në cdo fshat për ndihmën në kohë reale ndaj cdo shtetasi shqiptar.

Agjencia në shumë llojshmëri të punëve të ngarkuara si arsye fenomeneve natyrore të sipërpërmendura, nuk la pas dore detyrat e sajë funksionale si takimet me stafet e bashkive për integrimin, të cilat u organizuan me takime të ngushta si dhe në platformat e komunikimit në distancë si arsye e pandemisë. Gjithashtu Agjencia nëpërmjet takimeve të bëra në bashki orientoi këshillat bashkiak për miratimin e rregulloreve të funksionimit të këshillave. Gjithashtu agjencia bëri takime me bashkitë për buxhetin e vitit 2021 etj,

KAPITULLI I

6.1 Reforma e Decentralizimit në Shqipëri

Reforma Administrativo-Territoriale, si pararendëse e një sërë reformash të qeverisë vendore, krijoi një kuadër të ri dhe të favorshëm për fuqizimin e institucioneve të qeverisë vendore dhe për efikasitetin në ofrimin e shërbimeve, si dhe ridimensionoi sfidat për avancimin e demokracisë lokale dhe angazhimin e qytetarëve në çështjet publike. Gjatë 3 vjetëve të fundit, krahas zbatimit në vijimësi të programit të decentralizimit, është zhvilluar më tej kuadri institucional, ligjor e rregullator në mbështetje të reformës së pushtetit vendor. Mirëqeverisja vendore mbetet sfidë kyçe në rrugëtimin drejt integritit në BE.

Procesi i decentralizimit në Shqipëri ka kaluar në disa etapa thelbësore, më e fundit e të cilave është ajo e vitit 2014, ku në bazë të ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", territori u nda në 61 njësitë bazë të qeverisjes vendore nga 373 që ishin më parë.

Reforma Administrative Territoriale (RAT) e filluar në vitin 2014, së bashku me avancimin e procesit të decentralizimit paraqet forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik në nivel vendor.

RAT dhe procesi i decentralizimit në Shqipëri evidentoi përfitime në disa drejtime kryesore si:

- (i) përmirësimi i ofrimit të shërbimeve në terma të cilësisë dhe kohës së ofrimit dhe shtimi i numrit të shërbimeve administrative nëpërmjet ngritjes së OSSH,
- (ii) përmirësim i qeverisjes dhe llogaridhënies publike,
- (iii) rritje e efikasitetit të NJQV dhe
- (iv) rritje e Demokracisë në nivel vendor.
- (v) Plane zhvillimore rajonale më të qarta dhe të personalizuara sipas rajoneve,

- (vi) Rritje të autonomisë së pushtetit vendor dhe aftësinë për të ushtruar funksione (decentralizimi me parimin financa ndjek funksionin),
- (vii) rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifrat vendore të mbledhura nga bashkitë dhe një menaxhim më eficient të burimeve të saj,
- (viii) përmirësimin e treguesve makroekonomikë lidhur me planifikimin e të ardhurave për pushtetin vendor.

Ndër të tjera, përshtatja e strukturës së ministrisë me një drejtori për çështjet vendore dhe ristrukturimin e Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT) në Agjenci të Mbështetjes së Vetë-Qeverisjes Vendore (AMVV) për asistencë direkte 61 bashkive dhe përpjekjet e bëra për ta transformuar Këshillin Konsultativ si një instrument dialogu, transparence, janë evidentuar si ndër pika të rëndësishme të procesit të decentralizimit.

Mbështetur mbi vlerësimet e RAT dhe strategjisë së decentralizimit, kryesisht te rishikimi afatmesëm (RAM) i Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV), i cili vlerëson progresin e bërë në zbatimin të strategjisë , u konstatua se strategjia ishte relevante por që ishte e nevojshme që të rishikohej plani i veprimit të saj i cili hyri në fuqi në tetor 2020 dhe ka një shtrirje kohore deri në fund të vitit 2022.

Po ashtu nëpërmjet një analize të detajuar të bazës ligjore që influenconte nivelin vendor u përcaktuan të gjitha ndryshimet ligjore të nevojshme që duhet të bëheshin në nivele sektoriale. Me kontributin e Agjencisë për Mbështetjen e vetëqeverisjes Vendore, gjatë viteve 2019 dhe 2020 u bë e mundur që mbi 80% e të gjithë bazës ligjore të plotësohej dhe të bëjë të mundur një implementim sa më të mirë të planit të ri të veprimit të strategjisë.

Vlerësimi i reformës dhe decentralizimit në vend është bazuar edhe në Vlerësimin Mbarëkombëtar të Situatës së Qeverisjes Vendore në Shqipëri lidhur me perceptimin e qeverisjes nga 12,000 qytetarë. Nga këto vlerësime dolën përmirësimet në disa prej funksioneve të kaluar bashkive.

Sidoqoftë, në kuadër të përmirësimit të mbarëvajtjes së këtij procesi, ka ende nevojë për të intesifikuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisë vendore dhe asaj qendrore, për të përputhur bazën ligjore (me akte ligjore dhe nënligjore) me funksionet, implementimin e funksioneve të reja, inventarizimin e pronave dhe vazhdimin e punës për rritje të kapaciteteve të bashkive, menaxhim më eficient të financave vendore.

6.2 Veprimtaria e Këshillit Konsultativ

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ të Qeverisë Qendrore me Qeverinë Vendore (Këshilli) parashtron veprimtarinë e Këshillit Konsultativ për periudhën raportuese. Ky raport ka për qëllim të përshkruajë veprimtarinë e Këshillit gjatë vitit 2020, si dhe të analizojë arritjet e mangësitë e tij në drejtim të përmbushjes së funksioneve të tij ligjore.

Veprimtaria e Këshillit është përshkruar nëpërmjet katër grupe treguesish të cilët përfaqësojnë drejtimet kryesore të funksioneve të tij, dhe janë objekt i analizës vjetore të performancës e efektivitetit të tij.

Grupi 1: Mbi diskutimin e projekt akteve ligjore

Grupi i parë janë treguesit të cilët përshkruajnë veprimtarinë e Këshillit gjatë vitit 2020 në lidhje me projekt aktet ligjore të paraqitura në Këshill për diskutim, të diskutuara, të pa diskutuara, të miratuara e të pa miratuara. Përqindja e projekt akteve ligjore të diskutuara përlllogaritet përkundrejt numrit të atyre të paraqitura për diskutim, dhe përqindja e projekt akteve ligjore të miratuara, përkundrejt numrit të atyre që diskutohen.

Grupi 2: Mbi zbatimin e urdhrit të Kryeministrit nr. 101, datë 03.07.2019

Grupi i dytë janë treguesit të cilët përshkruajnë ecurinë e zbatimit të urdhrit të Kryeministrit nr. 101, datë 03.07.2019, “Për hartimin e akteve nënligjore nga ministrinë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për funksionet e deleguara njësisive të vetëqeverisjes vendore”. Nga 63 projekt aktet ligjore të parashikuara në këtë urdhër, 58 prej tyre janë të vlefshme për zbatim, ndërsa 5 janë tashmë të pavlefshme si pasojë e ndryshimit të legjislacionit që prej hyrjes në fuqi të këtij urdhri. Për 58 projekt aktet ligjore të vlefshme të urdhrit, përlllogaritet numri i projekt akteve ligjore të paraqitura në Këshill për diskutim, e përkundrejt këtij të fundit, gjithashtu dhe numri i projekt akteve ligjore të diskutuara, të miratuara e të pa miratuara.

Grupi 3: Mbi zbatimin e Matricës së Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore

Grupi i tretë janë treguesit të cilët përshkruajnë ecurinë e zbatimit të Matricës së Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore. Nga 101 rekomandimet e këtij dokumenti, 96 adresojnë projekt akte ligjore, dhe prej këtyre, 88 janë të vlefshëm për zbatim, ndërsa 8 janë tashmë të pavlefshëm si pasojë e ndryshimit të legjislacionit që prej momentit të hartimit të tij. Për 88 rekomandimet e vlefshme të urdhrit, përlllogaritet numri i projekt akteve ligjore të paraqitura në Këshill për diskutim, e përkundrejt këtij të fundit, gjithashtu dhe numri i projekt akteve ligjore të diskutuara, të miratuara e të pa miratuara.


Grupi 4: Mbi përfaqësimin e Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore

Grupi i katërt janë treguesit të cilët përshkruajnë nivelin e përfaqësimit në mbledhjet e Këshillit të anëtarëve të saj nga Qeveria Qendrore dhe ajo Vendore. Niveli i përfaqësimit mbi bazën e të cilit janë ndërtuar këta tregues është ai i cili i ngarkohet anëtarëve të Këshillit sipas VKM-së nr. 910, datë 21.12.2016 “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në dy drejtime kryesore: (i) prania në mbledhje, dhe (ii) niveli hierarkik i përfaqësuesit.


Gjatë vitit 2020 në Këshill janë paraqitur për diskutim gjithsej 30 projekt akte ligjore, nga të cilat 9 projekt ligje dhe 21 projekt vendime. Këto projekt akte ligjore janë paraqitur kryesisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 11 prej tyre, e më tej 4 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 4 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 3 nga Ministria e Brendshme, dhe 3 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Deri para mbledhjes së fundit të datës 23 dhjetor, janë paraqitur në Këshill për diskutim 24 projekt akteve ligjore, nga të cilat 16 janë diskutuar, që përbën rreth 67% të tyre. Nga këto, 6 janë projekt ligje ndërsa 10 janë projekt vendime, përkatësisht rreth 75% dhe 63%.

Projekt akte ligjore 2020




Projekt akte ligjore 2020




Numri i projekt akteve ligjore të miratuara është 15, që përbën rreth 94% të atyre të diskutuar. Nga këto, janë miratuar të gjitha projekt ligjet e diskutuar dhe 90% e projekt vendimeve.

Gjatë vitit 2020 në Këshill janë paraqitur për diskutim gjithsej 7 nga 58 projekt aktet ligjore të vlefshme të urdhrimit të Kryeministrit nr. 101, datë 03.07.2019; 5 nga 7 projekt aktet ligjore të paraqitura për diskutim janë diskutuar, dhe 4 prej tyre janë miratuar. Gjithsej, rreth 12% e projekt akteve ligjore të parashikuara nga urdhri janë paraqitur për diskutim në Këshill dhe 80% e tyre janë miratuar.

Projekt akte ligjore të urdhrimit të Kryeministrit



Projekt akte ligjore të urdhrimit të Kryeministrit




Gjatë vitit 2020 në Këshill janë paraqitur për diskutim gjithsej 7 nga 88 projekt aktet ligjore të vlefshme të rekomanduara në Matricën e Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore; janë të njëjtat projekt akte të parashikuara nga urdhri i Kryeministrit. Kështu, 5 nga 7 projekt aktet ligjore të paraqitura për diskutim janë diskutuar, dhe 4 prej tyre janë miratuar. Gjithsej, rreth 12% e projekt akteve ligjore të rekomanduara nga Matrica janë paraqitur për diskutim në Këshill dhe 80% e tyre janë miratuar.


Mesatarisht, gjatë vitit 2020 kanë qenë të pranishme në mbledhjet e Këshillit 40% e ministrive të linjës që kanë përbërë kabinetin e qeverisë qendrore gjatë këtij viti. Nga 11 ministri që përfaqësohen në Këshillin Konsultativ, 2 prej tyre kanë qenë të pranishme në të gjitha mbledhjet, ose 18% e ministrive gjithsej; 1 ministri ka qenë e pranishme në 4 nga 5 mbledhjet, ndërsa ministrinë e tjera kanë qenë të pranishme në 1 deri 2 mbledhje; 3 ministri, që përbëjnë 27% të ministrive gjithsej, nuk kanë qenë të pranishëm në asnjë mbledhje të vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, 2 ministri kanë qenë të pranishme në Këshill me përfaqësues ministrin, secila në 1 mbledhje. Gjatë vitit 2020, 1 ministri është përfaqësuar në të gjitha mbledhjet me zv. ministrin; ndërsa 1 ministri nuk është përfaqësuar në asnjë mbledhje me zv. ministrin. Me përjashtim të rasteve të mësipërme, ministrinë kanë qenë të pranishme në Këshill me përfaqësues të niveleve më të ulëta hierarkike.

Prania në mbledhje e Qeverisë Qendrore 2020



Përfaqësimi me zv. ministër 2020



Nga 11 anëtarët përfaqësues të qeverisë vendore, Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë dhe Shoqata për Autonominë Vendore kanë qenë të pranishme në të pesta mbledhjet e vitit 2020 të Këshillit. Anëtari i vetëm i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë nuk ka qenë i pranishëm në asnjë nga mbledhjet e vitit 2020, ndërkohë kjo shoqatë është përfaqësuar në çdo mbledhje të vitit 2020 nëpërmjet drejtorit ekzekutiv të saj.

Mesatarisht 12 bashki kanë qenë të pranishme në mbledhjet e vitit 2020, që përbën rreth 20% të bashkive të vendit; megjithatë, numri është luhatur ndjeshëm ndërmjet mbledhjeve, nga 2 në 28 bashki të pranishme.

Mesatarisht 9 bashki kanë qenë të pranishme në mbledhjet e vitit 2020 me përfaqësues kryetarin, që përbën rreth 75% të bashkive të pranishme. Pjesa tjetër, kanë qenë të pranishme me përfaqësues të niveleve më të ulëta hierarkike.

Në lidhje me përfaqësimin e QQ-së, në krahasim me kërkesat ligjore

- ❑ Përgjithësisht, niveli i përfaqësimit në Këshill gjatë vitit 2020 të qeverisë qendrore është i ulët përkundrejt kërkesave ligjore për praninë në mbledhje dhe nivelin hierarkik të përfaqësuesit.
- ❑ Në drejtim të pranisë në mbledhje, niveli mesatar i pjesëmarrjes së ministrive arrin në 40%, ndërkohë që 27% e tyre nuk kanë qenë të pranishme në asnjë mbledhje. Përgjithësisht,

vërehet se ministrinë, marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit vetëm nëse agjenda e saj përfshin çështje ose projekt akte ligjore që lidhen me fushën e saj të përgjegjësisë.

- Në drejtim të nivelin hierarkik të përfaqësuesit, vërehet një nivel i ulët përfaqësimit me zv. ministrin, ndërsa pjesa më e madhe e ministrive përfaqësohen me nivele më të ulëta hierarkie në pjesën më të madhe të mbledhjeve.

Në lidhje me përfaqësimin e QV-së, në krahasim me kërkesat ligjore

- Përgjithësisht, niveli i përfaqësimit në Këshill gjatë vitit 2020 të qeverisë vendore është i lartë përkundrejt kërkesave ligjore për praninë në mbledhje dhe nivelin hierarkik të përfaqësuesit.

Në zbatim të VKM-së 910, datë 21.12.2016 " "Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore i ndryshuar", përcaktohet se roli i Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ kryhet nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Sekretariati Teknik kryen detyrat e mëposhtme:

- Administrojnë faqen zyrtare të Këshillit Konsultativ dhe përcakton rregullat e hyrjes në këtë faqe në internet;
- Mbledh dhe përpunon komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e anëtarëve të Këshillit Konsultativ dhe njësisve të tjera të vetëqeverisjes lokale në procesin e konsultimit;
- U dërgon anëtarëve të Këshillit Konsultativ, Këshillit të Ministrave, ministrive përkatëse ose institucioneve të tjera shtetërore informacionin e përpunuar dhe dokumentacionin shoqërues;
- Monitoron dhe zbaton rekomandimet e Këshillit Konsultativ;
- Asiston dhe mbështet Këshillin Konsultativ në punën dhe drejtimin e takimeve;
- Me kërkesë të bashkëkryetarëve ose Këshillit Konsultativ, përgatit raporte dhe studime për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë së Këshillit;
- Merr procesverbalet e takimeve punuese dhe plenare të Këshillit Konsultativ dhe i publikon në faqen e internetit;
- Përgatit informacione periodike mbi veprimtarinë e Këshillit Konsultativ;
- Është përgjegjës për të bërë njoftime për anëtarët e Këshillit Konsultativ;
- Me propozim të Këshillit Konsultativ, njofton dhe merr miratimin paraprak të çdo fondi nga fondet publike ose lehtësira të tjera të siguruara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale nga Komisioni i Ndhmës së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, në përputhje me legjisllacionin e ndihmës shtetërore , përpara se skemat e ndihmës shtetërore të zbatohen;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Këshilli Konsultativ ose në këtë vendim.

Lista e përgjegjësive të Sekretariatit Teknik është rritur nga ato fillestare, veçanërisht në lidhje me detyrat e lidhura me proceset e integritimit evropian dhe në mbështetje të Këshillit Konsultativ.

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ është ura lidhëse midis qeverisë qendrore dhe atyre vendore, është e nevojshme të ri-strukturohet funksionimi i saj për të siguruar përfundimisht nëpërmjet NJVV-ve, shërbime më të mira për qytetarët dhe efektivitet të kostove për njësitë

bazike të qeverisjes vendore. Ky ri-konceptim synon një rritje të rëndësishme të koordinimit midis qeverisë qendrore dhe njësisë vendore, që bashkitë të ndihmohen me analiza dhe rishikime konkrete mbi të cilat të bazojnë politikat e tyre të zhvillimit.

Në këtë kontekst, Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ duhet të konsolidojë rritjen e rolit të Këshillit Konsultativ (KK) – është e nevojshme të ketë një rol më të madh në analizat e detajuara në nivelet sektoriale bashkiake.

Gjetjet

Për çdo ndryshim ligjor që ndikon qeverisjen vendore, duhet të ketë ndërveprim të qëndrueshëm midis ministrisë së linjës ose institucionit iniciues dhe stafit të sekretariatit të këshillit konsultativ. Kjo procedurë duhet të nisë nga momenti i konceptimit me qëllim bërjen të mundur të një konsultimi të gjerë me bashkitë dhe qytetarët dhe të një analize të detajuar të ndikimeve socio-ekonomike që ky konsultim do të sjellë. AMVV-ja mund të lehtësojë forumet e konsultimit dhe koordinimit dhe mund të kontribuojë në shumë analiza.

Gjithashtu, Këshilli Konsultativ duhet të ndjekë periodikisht dhe të monitorojë çdo ndryshim ligjor që është vendosur në takimet e Këshillit, për të analizuar se si janë realizuar, sa komente janë dhënë nga bashkitë ose institucione të tjera të interesuara për qeverisjen vendore.

Arritja e këtyre objektivave të lidhura me një prej detyrave më esenciale të Sekretariatit Teknik, kompletimi i bazës ligjore për qeverisjen vendore, kërkon një staf të dedikuar me njohuri të thella mbi aspektet ligjore.

Analizat e thelluara bazohen në përpunimin e të dhënave dhe në monitorimin në nivel vendor. Sekretariati Teknik duhet të bëjë raporte analitike me frekuenca të ndryshme kohore për të ndihmuar strukturat përkatëse në nivelin vendor dhe atë qendror. Këto raporte duhet të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera, specifikuat me ministritë e linjës të cilat nxjerrin statistikat në nivel vendor.

Rritja e cilësisë së diskutimeve publike: cilësia e diskutimeve publike shpesh ka të bëjë me një mungesë profesionalizmi për sa i përket qasjes dhe performancës. Kjo është edhe e theksuar në raportin më të fundit të përgatitur nga UNDP (Vlerësimi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri) mbi performancën e qeverive vendore në vitin 2020 ku vihet re që një nga pikat me performancë në rënie ka qenë ajo në lidhje me pjesëmarrjen civile.

Projekt akte të paraqitura për diskutim
Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në Mjedis".
Projektligj "Për Tregjet e Kapitalit".
Projektligj "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive".
Projektligj "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin"
Projektligj "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"
Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar.
Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare" të ndryshuar.
Projektligj "Për Buxhetin" (Buxheti vendor 2021)
Projektligj "Për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve Inovative".
Projektvendim për "Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale.

Projektvendim "Për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillimit Kombëtar të Strehimit, si dhe Marrëdhëniet me Institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë".
Projektvendim "Strategjia e Zhvillimit të Kujdesit Shëndetësor 2020-2025".
Projektvendim "Për përcaktimin e masës, kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit, për personat me aftësi të kufizuar si dhe ndihmësit personal të tyre".
Projektvendim "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit mbi Deinstitutionalizimit 2020-2023 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij".
Projektvendim "Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme".
Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1108, datë 30.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin nga Ministra e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit", të ndryshuar".
Projektvendim "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave".
Projektvendim "Për mbështetjen financiare të njërive të qeverisjes së përgjithshme dhe procedurat e kompensimit financiar për zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian".
Projektvendim "Për përcaktimin e specifikimeve teknike të tabelave të emërtimeve të bulevardëve, rrugëve, rrugicave, shesheve, e parqeve dhe të numërimit të ndërtesave".
Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive".
Projektvendim "Mbi kriteret për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, për strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre".
Projektvendim "Kriteret për përzgjedhjen, mënyrën e kontraktimit, formën dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin".
Projektvendim "Për miratimin e rregullave teknike në projektimin dhe ndërtimin për furnizimin me ujë dhe kanalizimin".
Projektvendim "Për miratimin e metodologjisë Kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa".
Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 11.07.2012 "Për lëndfillet e Mbetjeve".
Projektvendim "Për Miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".
Projektvendim "Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie".
Projektvendim "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu".
Projektvendim "Për Miratimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga prefekti i qarkut, me qëllim përfundimin e procesit të emërtimeve të pjesëve të territorit publik dhe të adresimit numerik të brendshëm e të jashtëm të objekteve ekzistuese në republikën e Shqipërisë, të pakryera nga njësitë e vetëqeverisjes vendore".
Projekt akte të pa diskutuara
Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në Mjedis".
Projektligj "Për Tregjet e Kapitalit".
Projektvendim "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit mbi Deinstitutionalizimit 2020-2023 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij".
Projektvendim "Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme".

Projektvendim "Për miratimin e rregullave teknike në projektimin dhe ndërtimin për furnizimin me ujë dhe kanalizimin"
Projektvendim "Për miratimin e metodologjisë Kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa"
Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 11.07.2012 "Për lëndfillet e Mbetjeve"
Projekt akte të pa miratuara
Projektvendim "Për rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale.

1. Produkti i Arritur

Mbledhjet e Këshillit Konsultativ kanë:

- Institucionalizuar procesin e konsultimit mes Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore duke informuar të gjithë palët për projektvendimet, projektligjet dhe projekt strategjitë që propozohen nga Qeverisja Qendrore.
- Realizuar mbledhjen e vërejtjeve, mendimeve, komenteve dhe propozimeve të bashkive dhe ia kanë bashkëlidhur praktikës dokumentare që shoqëron procesin vijues të vendimmarrjes përkatëse në Këshillin e Ministrave ose në Kuvend.
- Miratuar projektvendime që prekin funksionet dhe interesat e bashkive.
- Njohur paraprakisht Njësitë e Qeverisjes Vendore me masat që duhet të ndërmerren në kuadër të zbatimit të Ligjeve dhe VKM-ve.

Rritur transparencën duke përfshirë shoqatat dhe bashkitë në procesin e formulimit të projekt – akteve ose projekt-ligjeve

KAPITULLI II

7.1 Mbeshtetja e Bashkive

Në funksion të mbështetjes së bashkive, Agjencia në zbatim të detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 1038, datë 11.05.2009, për "Shëndetin Publik", i ndryshuar me ligjin nr.15/2016, datë 10.08.2016 "Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive" si dhe ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 105, datë 24.02.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për Marrjen e Masave Higjieno-Sanitare për Parandalimin e Përhapjes së Infeksioneve Respiratore Akute, përfshirë dhe Covid-19 në Institucionet Parashkollë, Kopshte dhe Çerdhe dhe Institucione të tjera Arsimore", AMVV-ja u caktua si bashkëpunëtorë në këtë proces si monitoruese, e cila do të monitorojë nga afër zbatimin e të gjitha detyrimeve të përcaktuara në këtë Urdhër. Agjencia ngriti një sistem raportimi periodik për të gjitha masat, detyrat, si dhe për çdo problematikë që do të hasni në këtë proces. Në zbatim të detyrave të përcaktuara në takimin e organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Përkrahjes Sociale, Agjencia ka bërë raportime periodike për masat që janë marrë nga Njësitë e Qeverisjes Vendore në zbatim të orjentive të dhëna nga qeveria për marrjen e masave higjieno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore.

Agjencia në bashkëpunim me Ministria e Brendshme ka punuar mbi hapjen e llogarive për çdo koordinator të bashkive, në mënyrë thjeshtësimin e punës dhe evidentimin sa më të kollajtë të rasteve të "Linjës së Gjelbër", duke vendosur në Platformën Ticket kredenciale për çdo punonjës bashkie, në mënyrë që kur koordinatorët të logohen automatikisht për bashkinë e tyre, të dalin të gjitha rastet e "Linjës së Gjelbër" vetëm për bashkinë përkatëse.

Në zbatim të detyrave të përcaktuara si pjesë e Task-Forcës së Shëndetësisë për COVID-19, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka ndjekur zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në të gjitha bashkitë, si dhe ka shpërndarë në kohë reale pranë të gjitha Njësive të Qeverisjes Vendore njoftimet, udhëzimet, urdhërat dhe vendimet e marra për pandeminë. Raportimet bëhen pranë task-forcës sipas kërkesës dhe rastit për çdo detyrë të dhënë, si dhe në Ministrinë e Brendshme në raportimet periodike.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 19.03.2020 “ Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid -19”, në muajin Mars 2020 filloi procesi i ngritjes së strukturave në të gjitha bashkitë e vendit. Ky proces përfundoi në muajin Prill 2020, pas bashkitë nuk i kishin plotësuar këto struktura sipas një modeli të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Ofritit të Asistencës në mënyrë që puna e secilit të ishte e matshme dhe e verifikueshme. Agjencia si Sekretariat Teknik i KQOA orientoi dhe ndihmoi të gjitha bashkitë në përfundimin me sukses të ngritjes së strukturës për ofrimin e ndihmës në zbatim të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020.

Në zbatim të VKM-se nr. 360, datë 29.05.2019 “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo- territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe në vijim të ushtrimit të funksioneve të sajë, Agjencia autoriteti përgjegjës për hartën e njësive të vetëqeverisjes vendore, ka kryer disa tanimë me bashki të ndryshme në lidhje me ndarjen territoriale. Pretendimet e bashkive kanë qenë nga me të ndryshmet. Agjencia si aktor kryesorë me projektin STAR, në procesin e përpilimit dhe propozimit të kësaj VKM-je, orientoi të gjitha bashkitë në zbatimin e ligjit dhe të vkm-së pasi ky proces ka filluar që pas miratimit të ligjit 115/2014, ku kanë qenë të përfshirë të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në përmbushje të këtij procesi. Të gjithë përfaqësuesit e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore janë trajnuar mbi “Dokumenti i kufirit territorial të 61 bashkive” dhe kanë marrë në dorëzim dosjet me materialet hartografike dhe fjalëkalimeve përkatëse në përdorimin e sistemit, sipas orjentimeve për këtë proces dhe ka pasë fushata konsultimesh me të gjitha Bashkitë.

AMVV-ja ka procesin e monitorimit për nëpërmjet e takimeve në Bashki, bazuar në udhëzimin plotësues nr. 27, datë 10.07.2020, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023” për planifikimin me sukses të planifikimit të buxhetit pas konsultave dhe rekomandimeve me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim njohjen e situatës aktuale të buxhetit të bashkisë, duke përkuar specifikisht bashkëpunimin e Bashkisë mbi pikat e poshtëcituar:

- 1- Takim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve, për t’ju ardhur në ndihmë për një planifikim të projektbuxhëtit në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit/ Pnanin e Përgjithshëm Vendor, si dhe Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal.
- 2- Paraqitjen e Projekt Buxhetit Vjetor në Këshillin Bashkiak brenda afatit 30 Nëntor 2020.
- 3- Miratimin e këtij Projekt Buxheti vjetor nga këshillat bashkiak brenda datës 25 Dhjetor 2020.

Në përfundim të procesit të monitorimit konkludoi se të gjitha bashkitë e vendit I kishin miratuar me vendim të këshillave bashkiake planet planet e tyre buxhetore mbi projektbuxhetet e vitit 2021.

7.2 Tërmeti



Në fundin e vitit 2019 Shqipëria u godit nga një tërmet me magnitudo 6.3 ballë, në pjesën perëndimore të vendit, duke përfshirë tre qarqe. Qarkun e Tiranës, Durrësin dhe atë të Lezhës. AMVV u caktua kryesisht në qarkun e Lezhës, por gjithashtu dhe në koordinimin e asistencës dhe në qarqet e Durrësit dhe Tiranës, Në Qarkun Lezhë, AMVV u caktua me detyrën e mbështetjes dhe me grupe pune në terren ku kontribuoi me dy grupe inspektorësh të AMVV në Qendrën Operacionale të Emergjencave Lezhë, duke bërë verifikimet në terren së bashku me grupet inspektuese për nevojat e të dëmtuarve nga tërmeti i 26.11.2019, në zbatim të udhëzimeve të KNEC-së.

Gjithashtu, në zbatim të vendimit nr. 4, datë 05.12.2019 të Kryetarit të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, në bashkëpunim me UNDP-in, Bashkimin Evropian dhe Bankën Botërore, në datat 17,18.12.2019 u zhvillua trajnimi ndërinstitucional me metodologjinë PDNA (vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë) që përdorin vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe PNUD-i. Qëllimi i këtij trajnimi është nxjerrja në vlerë monetare e dëmeve dhe kostove të dala nga tërmeti i datës 26.11.2019, për ta paraqitur këtë në formë shkresore në Konferencën e Donatorëve të datës 17.02.2020. Për të arritur këtë qëllim, me ndihmën e ekspertëve të huaj nga Bashkimi Evropian në fushat e vlerësimit të dëmeve dhe kostove, puna u organizua në 5 nëngrupe pune, për fusha të ndryshme. AMVV-ja u caktua në grupin e punës, për Mbrojtjen Civile dhe Analizën e Rrishtit. Detyra e AMVV-së në këtë nëngrup pune ishte koordinimi me pushtetin qendror dhe atë vendor, në sigurimin e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për mbarëvajtjen e punës. Nën-grupi i punës përbëhet nga 2 ekspertë të huaj, 2 përfaqësues të UNDP, 3 përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, si dhe nga 3 përfaqësues të AMVV-së. AMVV u angazhua dhe punoi për përgatitjen e materialit duke bërë vizitua në bashki dhe institucionet e qeverisë qendrore, për mbledhjen e të dhënave për Analizën e Rrishtit dhe Mbrojtjen Civile (DRR- Civil Protection). Në përfundim të këtij procesi, Kryeministri falenderoi të gjithë personat që kontribuan në hartimin e Raportit Përfundimtar të PDNA Albania, i cili rezultoi si i suksesshëm në konferencën e Donatorëve të datës 27.02.2020.


7.3 Pandemia

Raportim Kumulativ mbi Zbatimin në Terren të Asistencës Sociale


Numri total i familjeve² të asistuar për shërbime apo të ndihmuara me pako ushqimore deri më datë 29 Maj 2020 ishte 73,287 familje dhe 196,225 persona.³ Pjesa më e madhe e asistencës është dhënë në qarkun e Tiranës me 21.6% ndjekur nga qarku i Beratit me 10.2% ndërkohë që nivelet më të ulëta janë shënuar në qarqet e Durrësit me 3.1% dhe Kukësit me 5%




Asistenca është dhënë në të 61 bashkitë e vendit, ku numri më i lartë është në bashkinë e Tiranës me 12,645 familje të ndihmuara. Kjo bashki ndiqet nga bashkia e Beratit me 5,975 dhe bashkia e Gjirokastrës me 3,895 familje të ndihmuara.






Përgjithësisht, pothuajse në të gjitha bashkitë, asistenca/ndihma e dhënë familjeve ka qënë e shpërndarë si në shërbime edhe për ndarje pakosh ushqimore. Në nivel vendi 31.2% ose 22,878 e shërbimeve kanë qënë për asistencë, 67.6% ose 49,560 familje në ndarje pakosh ushqimore dhe 1.2% ose 849 familje në ndarje pakosh ushqimore dhe asistencë



Gjatë periudhës 8 Prill - 29 Maj, pra gjatë 52 ditëve, Bashkia e Gjirokastrës ka raportuar nivelin më të lartë të ditëve me 44 ditë, ndjekur nga bashkia Tiranë dhe Korçë me 32 ditë të raportuara



Gjatë periudhës 8 Prill - 29 Maj, pra gjatë 52 ditëve, numri më i lartë i raportimeve është bërë më datë 17 Prill, nga 57 bashki nga 61 që janë në total.



KAPITULLI III

8.1 Integrimi Evropian dhe përmbushja e detyrimeve sipas Marrëveshjes financiare IPA 2020

Qeverisja vendore ka rëndësi të vecantë në këtë proces. Ajo përbën element thelbësor në demokratizimin e vendit, në intensifikimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse. Pa një sistem solid, të qëndrueshëm, të efektshëm të qeverisjes vendore nuk mund të konsiderohet i plotë dhe thellesisht demokratik sistemi politik i vendit. Pushteti vendor luan rol kyc për zbatimin e kërkesave për përafrimin e legjislacionit tonë me legjislacionin Evropian dhe zbatimin e tij. Nuk është rastësi që rreth 70 përqind e legjislacionit të Bashkimit Evropian do të duhet të zbatohet saktë, në mënyrë të plotë dhe të drejtpërdrejtë nga pushteti vendor nga bashkitë.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me rrjetin e koordinatorëve të zyrave të integritit në BE-së ka forcuar përfshirjen e NJQV-ve në procesin e pranimit në BE, duke rritur ndërgjegjësimin mbi politikat e BE-së, *acquis-në* e BE-së, fondet dhe programet e saj. Zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave i korrikut të vitit 2018, i cili institucionalizon dhe përditëson të ashtuquajturat "kënde të BE-së" me "njësitë e BE-së" është përmbushur pothuajse plotësisht. Në janar të vitit 2020 u prezantua një raport i dytë mbi performancën e bashkive për integrimin në BE-së, në të cilin referohet dhe progresi i raportit të integritit në BE. Ministrinë e Brendshme si ministri përgjegjëse për pushtetin vendor, është angazhuar për ta bërë këtë ushtrim një proces të rregullt vjetor nën drejtimin e vet.

Një proces shumë i rëndësishëm për vitin 2020 ka qenë edhe procesi i monitorimit të zbatimit të Urdhrit 101, datë 03.07.2019 "Për hartimin e akteve nënligjore nga Ministrinë e Linjës, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për funksionet e deleguara njësitë të vetëqeverisjes vendore". Urdhri i Kryeministrit nr.101/2019 u sugjerua nga Ministria e Brendshme bazuar në rekomandimet e Matricës së Kompetencave për harmonizimin legjislativ. Paketat legjislative për ministrinë e linjës siguruan një udhërrëfyes të qartë për secilin ministri të linjës për të harmonizuar dhe kompletuar plotësisht kuadrin ligjor dhe institucional sektorial në lidhje me njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe në përputhje me Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore.

Më saktësisht, Urdhri përfshin gjithsej 71 rekomandime, të cilat ndahen në 82 akte nënligjore (Vendime të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzime), ku: 10 rekomandime për Ministrinë e Brendshme, 1 rekomandim për Ministrinë e Mbrojtjes, 20 rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, 5 rekomandime për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 10 rekomandime për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, 16 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, 1 rekomandim i përgjithshëm për Ministrinë e Kulturës, i cili ndahet në 11 akte nënligjore, dhe 9 rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nëpërmjet kontrollit të fletores zyrtare dhe Këshillit Konsultativ të projektvendimeve, urdhrave dhe udhëzimeve është bërë i mundur monitorimi i zbatimit të këtij urdhri. Mund të thuhet se zbatueshmëria ka arritur afër 90%, ndërsa ka nevojë për konfirmime zyrtare të disa prej Ministrive. Më shumë detaje paraqiten në Aneksin 1 të këtij raporti.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim dhe bashkërendim me projekti “Bashkitë për në Evropë” për procesin e integrimin në BE, bënë të mundur monitorimin e performancës mbi bazën e analizës së treguesve për sektorë dhe fusha të ndryshme, përfshijnë demokracinë vendore, shtetin e së drejtës, administratën publike, të drejtat e njeriut dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të veta të NJQV. Raporti analizon informacionin për vitin 2019, duke bërë kështu një krahasim ku është e mundur të prirjes së treguesit nga viti 2017 dhe 2018 mbi bazën e të dhënave të vlefshme. Të dhënat e raporteve të vlerësimit duke filluar nga viti 2018 publikohen on-line në adresën <https://mapping-bpe.al/goDataAnalyze/online.aspx>, si dhe në faqen e internetit të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

8.2 Diaspora

Në Zbatim Ligjit 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nëpërmjet Marrëveshjes së Bashkëpunimit të firmosur nga Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Shoqata për Autonominë Vendore, këto institucione kanë filluar punën për ngritjen e këtyre strukturave administrative pranë bashkive, për Diasporën dhe Migracionin. Në këtë kuadër Agjencia ër Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, me orjentimin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shtetit për Diasporën bashkërendoi një dialog virtual shumëpalësh në lidhje me kalimin e përgjegjësisë për Diasporën dhe Migrimin në nivel vendor të qeverisjes. Ky dialog u zhvillua nga Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në kuadër të programit GIZ, Migrimi dhe Diaspora.

Në dialog morën pjesë rreth 40 vetë, përfaqësues të institucioneve qendrore që lidhen me diasporën dhe migrimin, katër bashkive kryesore në vend, Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Korçë, përfaqësues të shoqërisë civile, diasporës dhe ndërmarrjeve private si edhe përfaqësues të Ambasadës Gjermane dhe GIZ në Shqipëri.

Dialogu u ndal në diskutimin e Memorandumit të bashkëpunimit, për të koordinuar punën për zhvillimin e strukturave të menaxhimit të diasporës, midis Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Shoqatës për Autonominë Vendore. Konkluzionet e këtij dialogu orientojnë edhe më tej procesin e transferimit të menaxhimit të migrimit dhe diasporës në nivel vendor si më poshtë:

- Identifikimi i mënyrave më të mira për të ndërtuar plane vendore të zhvillimit strategjik të ndjeshme ndaj nevojave të Diasporës shqiptare dhe emigrantëve të kthyer.
- Analizimi në grup i hendeqeve dhe mundësive për t'i bërë planet e zhvillimit vendor më reaguese ndaj Diasporës shqiptare dhe migrantëve të kthyer.
- Shqyrtimi i mësimave të vlefshme të nxjerra nga qasje dhe kontekstet të tjera në rajon dhe në botë.
- Shtimi themelit për një qasje të përbashkët për përfshirjen e Diasporës dhe migracionit në planet vendore të zhvillimit strategjik, duke përcaktuar: kush duhet të përfshihet, cilat janë veprimet kryesore që duhet të ndërmarrë, afatet kohore dhe pikat fokusuese mes institucioneve.

Në përfundim të diskutimit pjesëmarrësit u përpoqën të qartësojnë se si mund të drejtohet në mënyrë aktive qeverisja vendore në zhvillimin e politikave të përshtatshme të Diasporës me një ndikim të caktuar në shfrytëzimin e burimeve nga Diaspora dhe Emigrantët e Kthyer për zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve lokale përmes angazhimit të tyre të drejtpërdrejtë në Planet Vendore të Zhvillimit Strategjik.

8.3 Projekti STAR

Sistemi OSIS

Agjencia është pjesë e zbatimit të Sistemit Informativ të Zyrave me Një Ndalesë (OSSH), për ofrimin e shërbimeve administrative vendore. AMVV në bashkëpunim me Projektin STAR 2 vazhdojnë të zhvillojnë aktivitete, inspektive si dhe mundësojnë asistencë mbi "Konsolidimin e Projektit të Reformës Administrative Territoriale". Kjo asistencë përfshin analizat, hartimin, zhvillimin, vendosjen, trajnimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen e përdoruesve. Kjo për ti ardhur në ndihmë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Në vitin 2020 janë ngritur 7 njësi të One Stop Shop të ngritura në bashkitë si më poshtë:

Gjate periudhës 2018-2020, janë hapur gjithsej 48 OSSH, nga projekti STAR 2, ndërsa 11 të tjera, janë hapur para 2018 nga projekti DLDP, USAID dhe borxhi publik

Numri i OSSH është rritur në mënyrë graduale gjatë vitit 2020, jo vetëm falë bashkëpunimit me AMVV, por edhe se viti 2020 ishte viti i vështirësive pandemike dhe ato të tërmetit. Përgjithësisht, viti 2018 ka shërbyer për të studiuar fizibilitetin e zyrave me një ndalesë dhe gatishmërinë e bashkive nga pikëpamja infrastrukturore. Ndërkohë, puna për ngritjen e Zyrave me Një Ndalesë për bashkitë ka vazhduar në 2019 me një ritëm të kenaqshëm duke arritur numrin e tyre në 59 OSSH në vitin 2020.

Sa më lart, deri më tani janë ngritur **59 OSSH në të gjithë vendin**, (pra, 48 OSSH nga Projekti Star 2, 10 OSSH nga projekti USAID/ DLDP dhe 1 OSSH nga buxheti publik.)

Në 50 bashki, **ofrohen 76 shërbime administrative**, vetëm **Bashkia Tiranë ka të instaluar 130 shërbime**.

Dëshiroj të theksoj se numri i shërbimeve nuk është një element statik por është i ndryshueshëm bazuar në tipologjinë e shërbimeve që bashkia ofron. Stafet e bashkive përgjegjëse për OSSIS kanë kapacitetin të shtojnë shërbime të reja apo të ndryshojnë elementë të shërbimeve ekzistuese.

8.4 Projekti Bashkitë për në Evropë

Njësitë e Integrimit Evropian

Duke marrë parasysh vështirësitë në kuptimin e rolit të Njësive të Integrimit Evropian (NjIE) fokusi dhe puna e AMVV është bërë më e vështirë gjatë këtij viti i cili u prek nga tre ngjarje kryesore

- katastrofa natyrore
- dy tërmete që goditën Shqipërinë në tremujorët e treteëdhe të katërt të vitit 2019
- një sëmundje globale e përhapur që preku jetën dhe ekonominë në Shqipëri gjatë viteve 2019-2020.

Kjo situatë, në veçanti ajo pandemike, ka ndikuar edhe në zbatimin e synimit dhe pritshmërive të AMVV për vitin 2020. Pavarësisht se përsëri mbetemi të kënaqur që vemendja jonë mbi ngritjen e NjIE në zbatim të VKM 450/2018 vazhdon rrugën me këmbëngulje. Ekipi i AMVV-së në bashkëpunim me Projektin Bashkitë për në Europë rregulloi metodologjinë e punës dhe qasjen duke u zhvendosur kryesisht në punën online, duke përfshirë trajnime dhe ngjarje të mëdha që menaxhojnë të zbatojnë aktivitetet dhe rezultatet e ofruara në nivelin 99.2%. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, ka qenë e angazhuar dhe nëpërmjet

ngritjes së grupeve të punës për ta monitoruar më nga afër procesin në çdo bashki të vendit. Transformimi i Këndeve të BE-së në Njësi të BE-së përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.07.2018 u pasua nga një punë e gjatë koordinuese të AMVV-së në bashkëpunim me BPE për të zbatuar VKM. Pasqyrimi i të gjitha dispozitave të VKM në emërimin e stafit të Njësive të BE kërkoj më shumë përpjekje dhe përkushtim për të punuar individualisht me secilën nga Njësitë e BE dhe menaxhimin e tyre si dhe për të shpjeguar teknikat e krijimit të strukturave të reja në nivel bashkie. Procesi është monitoruar dhe pas përfundimit të projektit nga AMVV.

1. Hapat e Ndërrmara nga Agjencia:

AMVV së bashku me projektin “Bashki për Evropë” përgjatë vitit 2020 ka ofruar asistencë për ngritjen e strukturave të Integritit Evropian në nivelin vendor. Produktet e realizuara janë:

- Krijimi i Këndeve të Informimit të BE-së në 61 bashkitë të cilat u pajisen me elemente të dukshmërisë dhe u instaluan në hyrje të secilës bashki
- Institucionalizimi i Këndeve të BE-së dhe transformimi i tyre në Njësitë për Koordinimin e Procesit të Integritit Evropian dhe Ndihmës e Huaj.
- Krijimi i Rrjetit të Koordinatorëve Lokal të BE-së: 61 Koordinatorët Vendorë të BE-së tani kanë krijuar rrjetin si dhe janë pajisur me certifikatat e trajnimit.
- Trajnimi i 61 Koordinatorëve Vendorë të BE mbi politikën e BE-së dhe programet e BE-së (faza e parë)
- Mbështetje bashkive për procesin e aplikimit për fonde të BE-së, ku AMVV ka komunikuar dhe ka zhvilluar takime me bashkitë duke i informuar dhe adresuar se ku dhe si duhet të përthithin fondet.
- Ngritja e platformës on-line të komunikimit “Platforma Bashkitë për në Evropë” si dhe vlerësimi i Performancës- Mapping monitorimi dhe ndjekja nga AMVV. Raporti mbi “mapping” u shpërnda gjerësisht nga AMVV në internet tek donatorët, shoqëria civile dhe ministrinë e linjës. Raportet në kopje të shtypura u shpërndanë nga AMVV të gjithë kryetarët e bashkive, këshillat e qarqeve, komisioni parlamentar për çështjet e qeverisjes vendore, komisioni parlamentar për çështjet e integritit në BE dhe departamentet kryesore në Zyrën e Kryeministrit.
- Gjatë periudhës së vitit 2020 AMVV ka mbështetur procesin e plotë të hartëzimit si dhe mori përsipër menaxhimin e procesit të hartëzimit të asistuar nga projekti MfE.
- AMVV kanë ngritur të kryetarët e bashkive përkatëse nevojën për të siguruar infrastrukturën e duhur për Njësitë e BE-së

2. Zhvillime të tjera të cilat janë ndjekur nga AMVV

AMVV ka përgatitur një raport të monitorimit të performancës të Njësive të BE, në Tetor 2020. Duhet të theksohet se matja e performancës së Njësive të BE është e vështirë pasi shumë prej tyre nuk raportojnë në AMVV, pavarësisht se formati i raportimit ishte hartuar të ishte i thjeshtë dhe shumë konçiz. Në një krahasim me 2019 kemi vetëm 38 për 2019 dhe 20 për 2020 nga 61 bashki kanë dhënë raportet, duke e bërë kështu të vështirë për të kryer një vlerësim të duhur të aktiviteteve të tyre. Raporti i Performancës së bashkive për vitin 2019 u prezantua dhe diskutua për herë të parë në takimin e Këshillit Konsultativ në 29 Shtator 2020. Raporti i performancës së bashkive në saj të vlerësimi i 3-të: 2019 filloi në Nëntor 2019 dhe mbaroj në 2020. Në të dyja rastet, AMVV ka mbledhur, hedhur dhe përpunuar për të monitorimin e bashkive. Përdorimi i Sistemit Online të Raportimit reduktoi gabimet dhe shkurtoi kohën e raportimit. Më konkretisht, hedhja e të dhënave u realizua në masën 99.93%

AMVV ka punuar me ekspertë të projektit për të siguruar mbështetje gjatë periudhës për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga bashkitë mbi krijimin e Njësive të BE-së dhe monitorimin e aktiviteteve të tyre. Falë një mbështetjeje të tillë, AMVV ishte në gjendje të shqyrtonte me kujdes të gjitha dokumentet e paraqitura dhe të siguronte që Njësitë e BE-së ishin krijuar në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 456

Përgjatë gjithë vitit 2020 arritjet e AMVV-së në bashkëpunim me BPE mbi 61 Bashkitë e Shqipërisë:

- Organizmi i 248 aktivitete në drejtim të ngjarjeve të ndërtimit të kapaciteteve, organizimit të ngjarjeve në secilën bashki, hartëzimit, etj. Vetëm dy aktivitete nuk ishin të mundshme për të arritur qëllimin e planifikuar si evente të vogla të organizuara nga Njësitë e BE-së (planifikuar fillimisht 300 evente organizuar 248 evente).
- Organizim i turneut të dytë studimor i mbështetur nga TAIEX
- Deri në fund të tetorit 2020, vetëm 2 bashki kanë mbetur pa njësi të BE-së, ende të pa themeluara. Vora dhe Has. AMVV dhe MB po ndjekin këto bashki për të siguruar që struktura e re është planifikuar dhe organizative që do të miratohet në fund të Janar 2021.

Gjatë vitit të kaluar (Janar-Dhjetor 2020), bazuar në raportet e paraqitura janë vizituar Qendrat e Informimit të BE-së në bashkitë Vlore, Shkodër, Gjirokastra dhe Mirdita, me një mesatare prej 250 vizitorësh secila, e ndjekur nga Patos, Përmeti, me një gamë prej 170-200, Himarë, Belsh, Durrës, Korçë, Pogradec, Përrenjas me një gamë prej 90- 170 vizitorë, Elbasan, Berat, Dibër, Dropull, Fier, Gramsh, Kamëz, Këlcyre, Kurbin, Lezhe, Librazhd, Mallakastër, Mat, Memaliaj, Peqin, Përrenjas, Roskovec, Tepelenë me një interval nga 30-75 dhe i fundit kategori me një gamë nga 2-10 vizitorë si Bulqizë, Rrogozhinë, Shijak dhe Ura Vajgurore. Agjencia ka inkuarajuar bashkitë për të lançuar ne publik përdormin e zyrave të integritimit evropian ne kuadër të informimit mbi proceset e ndryshme te integritimit Evropian.

8.5 Projekti Bashkitë e Forta

1. Bashkitë në sfidën për arsim cilësor parashkollor.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me projektin Bashki të Forta dhe institucionet arsimore, qendrore dhe vendore, bashkërenduan informacione për situatën aktuale të arsimit parashkollor nëpërmjet iniciatives se projektit “Menaxhimi i Arsimit Parashkollor në Shqipëri” financuar nga projekti Bashki të Forta.

Arsimi parashkollor është ndër funksionet e fundit të decentralizuara te bashkitë shqiptare. Që nga janari i vitit 2019, bashkitë shqiptare jo vetëm që kanë ushtruar një kontroll më të madh menaxherial mbi funksionin e arsimit parashkollor, por gjithashtu filluan financimin e këtij funksioni nga të ardhurat e tyre të përgjithshme. Sidoqoftë, funksioni zbatohet - financimi, si dhe operacionet - me përgjegjësi të ndara midis nivelit kombëtar dhe atij vendor, ku qeveria qendrore siguron pjesën më të madhe të financimit, si dhe përcakton standardet e performancës që bashkitë duhet të përmbushin.

Kombet e Bashkuara e shohin zhvillimin e hershëm të fëmijërisë si shtytës kryesor të shndërrimit për të arritur Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kujdesi cilësor ndaj fëmijëve është një mjet i fuqishëm për të zvogëluar pabarazinë dhe për të nxitur përfshirjen sociale. Vitet e para të jetës së një fëmije ofrojnë një sërë mundësish për të bërë ndërhyrje që janë të përshtatshme për të mbyllur hendekun e pabarazisë për fëmijët e lindur në familje të disavantazhuara nga pikëpamja sociale.


Në Shqipëri, aktualisht ka rreth 79.000 fëmijë që përfitojnë nga shërbimi i arsimit parashkollor në rreth 2.000 kopshte publike dhe private. Janë rreth 4.800 mësues të punësuar në shërbimin parashkollor në 61 bashki (viti 2019).

Kjo strukturë institucionale, e cila nga njëra anë nënvizon decentralizimin e shërbimeve publike dhe nga ana tjetër thekson standardet e hollësishme kombëtare dhe kërkesat ligjore, shkakton fërkime, të cilat kufizojnë ofrimin e duhur të shërbimeve.

Përputhshmëria me Standardet Kombëtare të Arsimit Parashkollor

Bashkive u kërkohet të përmbushin një numër standardesh dhe kërkesash në të gjitha fushat përkatëse të funksionit të arsimit parashkollor të vendosura nga qeveria qendrore.

Situata e përputhshmërisë monitorohet nga anketimi kombëtar i arsimit parashkollor i cili është krijuar për të mbledhur, përshkruar dhe vlerësuar përputhshmërinë e bashkive dhe agjencive të tjera të dekoncentruara me standardet kombëtare dhe kërkesat ligjore në ofrimin e shërbimit të arsimit parashkollor. Një përmbledhje e 10 standardeve më të rëndësishme tregon se përputhshmëria me ato 10 standarde ndryshon nga njëra bashki të tjetra në Shqipëri. Disa bashki përmbushin më shumë se 80% të standardeve. Në përgjithësi, 22 bashki përmbushin më shumë se 60% të standardeve. Në anën tjetër, shtatë bashki përmbushin më pak se 40% të standardeve (shih Figura 1).




Duke parë standardet (shih Figura 2), mund të vërehet se standardi në lidhje me portalin “Mësues për Shqipërinë” ka nivelin më të lartë të përputhshmërisë, 55 nga 61 bashki e përdorin portalin. Nga ana tjetër, objektet arkitekturore kanë përputhshmërinë më të ulët, vetëm gjashtë nga 61 bashki kanë treguar se i ofrojnë këto lehtësi për fëmijët me aftësi të kufizuara.

1. Në anketimin kombëtar është e qartë se portali "Mësues për Shqipërinë" përdoret shumë gjerësisht, 93% e bashkive (mungojnë të dhënat = 2 bashki, N = 59) e përdorin portalin.

2. **Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës** si njësi e veçantë brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale po funksionon në 50 bashki (të dhëna që mungojnë = 2 bashki).

Figura 2: Numri i bashkive që përmbushin 10 standardet më të rëndësishme



3. Në anketimin kombëtar, 41 bashki (të dhëna që mungojnë = 4 bashki) kanë treguar se ato i përmbushin udhëzimet për **numrin e fëmijëve për grup**. 11 bashki kanë treguar se ato e përmbushin pjesërisht këtë standard.

4. Anketimi kombëtar tregon se në 33 nga 58 bashki (të dhëna që mungojnë = 3 bashki), 80 - 100% e kopshteve kanë ngritur **Bordin e Kopshtit** dhe **Këshillin e Prindërve**.

5. Në 22 nga 60 bashki, kopshtet nuk shërbejnë ushqim. Në pjesën tjetër të bashkive ku shërbehet ushqimi, 24 bashki e zbatojnë plotësisht menynë e MSHMS-së, 5 bashki e zbatojnë pjesërisht dhe 6 bashki nuk e zbatojnë aspak menynë e MSHMS-së.

Metodologjia

Anketimi kombëtar i gjendjes së arsimit parashkollor në bashkitë shqiptare mbështetet në një hulumtim intensiv të akteve ligjore dhe rregulloreve, si dhe standardeve që përcaktojnë kontributin, procesin dhe rezultatet e ofrimit të arsimit parashkollor. Në Tetor 2019, u organizuan dy seminare me përfaqësues nga ministrinë kombëtare si dhe përfaqësues nga bashkitë dhe institucionet parashkollore për të diskutuar dhe prioritetizuar standardet dhe kërkesat ligjore ekzistuese. Të dhënat u grumbulluan duke përdorur një pyetësor. Pyetësorët u plotësuan nga punonjësit e Zyrave Arsimore Vendore dhe punonjësit përgjegjës të njësive të administratës në bashki. U përgjigjën 60 nga 61 bashki, përveç kësaj 51 ZVAP-e dhe 4 DRAP-e gjithashtu dhanë informacion. Analiza e të dhënave u realizua nga ZHAË.

6. Gjithsej, 82 psikologë po punojnë me fëmijët e kopshteve në 52 bashki (të dhëna që mungojnë = 9 bashki).

Në 22 bashki, nuk ka psikolog. 34 nga 58 bashki kanë punësuar së paku një punonjës social.

7. Të dhënat e anketimit kombëtar tregojnë se në vitin 2019, 18 bashki e kanë përmbushur standardin e **hapësirës së brendshme për fëmijë**. Maksimalisht, një bashki siguron mbi 15 m² për fëmijë. Nga ana tjetër, 19 bashki nuk e respektojnë këtë standard.

8. Gjithsej, ka 60 **mësues mbështetës** në bashkitë shqiptare (të dhëna që mungojnë = 9 bashki, N = 52). 20 bashki kanë të paktën një

mësues mbështetës (të dhëna që mungojnë = 9 bashki, N = 52) pavarësisht nga fakti se 50 bashki raportojnë se kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopshtet e tyre

9. Në anketimin kombëtar, bashkitë kanë treguar se 780 mësues gjithsej kanë marrë pjesë në **programe dhe module kombëtare trajnimi** të hartuara nga ASCAP-i në vitin 2019 (të dhënat që mungojnë = 23 bashki, N = 38). 38% e mësuesve (të dhëna që mungojnë = 23 bashki, N = 38) kanë marrë pjesë në trajnime.

10. Në anketimin kombëtar, vetëm gjashtë bashki raportuan se kopshtet e tyre kanë **rampa dhe tualete të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara**. 28 bashki raportuan se të paktën disa nga kopshtet e tyre ofrojnë mundësi aksesimi për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike.

Konferenca Kombëtare "Arsimi Parashkollor mbi Perspektivën e Qeverisjes Vendore në Shqipëri": Rekomandimet

Konferenca "Arsimi Parashkollor mbi Perspektivën e Qeverisjes Vendore në Shqipëri" u organizua në 26 shkurt nga Bashki të Forta në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, në bashkërendim me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe me kontributin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si edhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Objektivi i përgjithshëm i konferencës ishte ndërgjegjësimi në lidhje me nevojën për të monitoruar dhe përmirësuar shërbimet e arsimit parashkollor që nga decentralizimi i përgjegjësisë së tij te bashkitë. Rekomandimet e mëposhtme u dhanë gjatë konferencës dhe meritojnë vëmendje të mëtejshme.

1. Financimi

Përputhshmëria e bashkive me standardet dhe kërkesat ligjore nxori në pah se përputhshmëria është e lartë në fushat që nuk kanë kosto shumë të larta (p.sh. Përdorimi i Portalit "Mësues për Shqipërinë", Ngritja e Bordit të Kopshtit dhe Këshillit të Prindërve) ndërsa përputhshmëria në fushat me kosto të larta (aksesueshmëria, trajnimi i mësuesve ose numri i mësuesve mbështetës) mbetet shumë prapa.

Prandaj, gjatë konferencës u dhanë disa rekomandime:

- **Rritja e financimit:** Në dritën e standardeve dhe kërkesave ligjore për arsimin parashkollor, duhet të rishikohet vlera e transfertës për këtë shërbim. Duhet të merret parasysh shtimi i fondeve për arsimin parashkollor në mënyrë që t'u mundësohet bashkive përballja edhe me detyrimet me kosto të lartë.
- **Baza financiare për secilën kërkesë:** Duke u mbështetur në standardet e arsimit parashkollor, duhet të përcaktohet një bazë financiare për financimin e secilës prej kërkesave të këtij funksioni. Për më tepër, duhet të përcaktohet një bazë financiare për kontributin nga të ardhurat e veta që njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë për këtë funksion.
- **Agregimi i shpenzimeve:** Meqenëse financimi vjen nga një larmi burimesh, duhet të jetë përparësi identifikimi dhe agregimi i të gjitha shpenzimeve që lidhen me arsimin parauniversitar nga ministri të ndryshme të linjës ose programe të ndryshme të buxhetit të bashkisë.

- **Rishpërndarja midis zonave rurale dhe urbane:** Kontributet financiare duhet të rishpërndahen për të ekuilibruar pabarazitë midis zonave rurale dhe urbane.
- **Hartimi i Planeve të Përmirësimit të Shërbimit:** Bashkitë duhet të hartojnë plane për përmirësimin e shërbimit që duhet të jenë me kosto efektive duke optimizuar burimet ekzistuese.

2. Kontekst dhe përgjegjësi me shumë nivele

Krijimi i arsimit parashkollor si një funksion de fakto i përbashkët ka krijuar shumë fërkime dhe përgjegjësi të mbivendosura.

- **Caktimi i një autoriteti përgjegjës:** Duhet t'i jepet përparësi shmangies së përgjegjësive të përbashkëta duke caktuar një autoritet përgjegjës sipas parimit të subsidiaritetit.
- **Shndërrimi i udhëzuesit në një standard:** Udhëzuesi i hartuar nga Grupi i Punës shpjegon rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme dhe për këtë arsye rekomandohet që të përdoret si një mjet i përditshëm i punës nga autoritetet vendore dhe zyrat arsimore vendore dhe drejtoritë rajonale, të cilët duhet të trajnohen në lidhje me këtë instrument. Udhëzuesi gjithashtu duhet të përditësohet rregullisht kur ligjet dhe rregulloret ndryshojnë. Ai duhet të shërbejë si bazë për përcaktimin e Procedurave të Brendshme Standarde për institucionet rajonale dhe vendore.

Përgjegjësitë e qarta do të lehtësojnë proceset dhe do t'i bëjnë më pak të mundshme fërkimet. Një udhëzues reference do të çojë në standardizim dhe krahasueshmëri më të lartë të proceseve në arsimin parashkollor nëpër bashki.

3. Menaxhimi i të dhënave

Planifikimi i funksionit të arsimit parashkollor varet shumë nga parashikimi i saktë i numrit të fëmijëve në moshën e kopshtit dhe atyre të një moshe më të vogël. Sidoqoftë, regjistri i vaksinimeve përdoret aktualisht për të identifikuar numrin e fëmijëve në moshën e kopshtit, i cili jep vetëm një numër jo të saktë të fëmijëve. Kjo çon në planifikimin e gabuar të burimeve.

- **Identifikimi i fëmijëve në moshën e kopshtit:** Duhet të ketë një marrëveshje midis qeverisë vendore dhe qendrore të shoqëruar me burimet e nevojshme për të identifikuar plotësisht fëmijët në moshën 0-2 vjeç, 3-6 vjeç, me përparësi për fëmijët e moshës 5-6 vjeç .
- **Krijimi i një sistemi regjistrimi online:** Propozohet të krijohet një sistem për regjistrimin online të fëmijëve të administruar nga bashkitë duke u mbështetur në verifikimin e mësipërm.

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave përbën thelbin e çdo procesi planifikimi. Aksesimi ndaj të dhënave të besueshme duhet të jetë një përparësi.

4. Materialet

Për blerjen e pajisjeve, mjeteve dhe shërbimeve të tjera, MASR-i zbaton procedurat e prokurimit publik dhe njofton DAR-in për listën e mjeteve të mësimnxënies së përfituesve. Ato përkufizohen nga MASR-i çdo vit si një listë zyrtare e mjeteve didaktike dhe librave për bibliotekat e shkollave.

- **Lista alternative e librave dhe materialeve:** Ministria e Arsimit duhet të sugjerojë një listë alternative të librave në bazë të të cilave drejtorët e kopshteve, në bashkërendim me këshillat e prindërve dhe bordet e kopshteve, mund të zgjedhin librat / materialet didaktike më të përshtatshme.

Dhënia e mundësisë për më shumë larmi në materialet didaktike i lejon kopshtet që të përshtatin shërbimin e tyre për nevojat e fëmijëve dhe kontekstin vendor. Sidoqoftë, të gjitha materialet didaktike janë miratuar nga MASR-i.

5. Psikologët dhe Punonjësit Socialë

Ka të dhëna se transferimi i këtij shërbimi nuk është shoqëruar me transferimin e njëkohshëm të burimeve njerëzore ose financiare. Për momentin, shërbimi nuk ofrohet në kopshtet që nuk ndodhen brenda ndërtesave të shkollave fillore. Për më tepër, raporti standard nxënës/psikolog është zvogëluar në nivelin e shkollave fillore, kështu që ka pak mundësi që psikologët ekzistues të përdoren për sistemin e arsimit parashkollor.

6. Burimet Njerëzore

Në procesin e punësimit të mësuesve, është e detyrueshme të përdoret portali “Mësues për Shqipërinë”, i cili ofron informacione në lidhje me aplikimet online, vendet e lira, renditjen e kandidatëve, si dhe shpalljen e fituesit.

- **Më shumë elasticitet për bashkitë:** Rekomandohet që portali “Mësues për Shqipërinë” të përmbajë kërkesa shtesë nga secila bashki për të pasqyruar nevojat dhe shumëllojshmërinë e tyre.
- **Bashkia si punëdhënës:** Bashkia duhet të konsiderohet si punëdhënësi, dhe jo drejtori i kopshtit. Kjo zgjidh edhe problemin e çështjes së vulës.

Më shumë elasticitet në përdorimin e portalit lejon përshtatjen e procesit të punësimit në kontekstin vendor pa i zbutur standardet dhe udhëzimet kombëtare. Konsiderimi i bashkisë si punëdhënës përmirëson procesin e marrjes në punë dhe e bën atë më të mirë në përputhje me procesin e punësimit në administratën publike.

7. Menyja

MSHMS-ja miraton udhëzimet kombëtare për ushqyerjen e shëndetshme për grupe të ndryshme të popullsisë, si dhe harton politikat e nevojshme për të mbështetur ushqyerjen e shëndetshme, duke u mbështetur në përparësitë kombëtare. MSHMS-ja publikon një listë të hollësishme të menysë për çdo ditë të vitit për kopshtet.

- **Më shumë pavarësi në përcaktimin e menyve:** Rekomandohet që bashkitë të kenë kompetenca në zgjedhjen e më shumë alternativave nga ato të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. MSHMS-ja duhet të përcaktojë kriteret e ushqyerjes ndërsa Bashkitë kanë pavarësinë në planifikimin e menysë.

- **Programet e Edukimit të Ushqyerjes:** Rekomandohet nismëtimi i programeve të Edukimit të Ushqyerjes për prindërit dhe mësuesit e parashkollorit. Këto trajnime mund të ndërmerren nga Bashkitë në bashkëpunim me Ministrinë.

Më shumë elasticitet në menynë e përditshme i lejon kopshtet të përgatitin ushqim që është në përputhje me prodhimin vendor të ushqimit dhe gjellët/pjatat e vendit. Një efekt anësor i mundshëm mund të jetë që përgatitja e ushqimit të bëhet më pak e kushtueshme. Programet e Edukimit të Ushqyerjes ndihmojnë në sigurimin e fëmijëve me ushqim më të shëndetshëm brenda dhe jashtë arsimit parashkollor dhe kësajsoj kontribuojnë në shëndetin e përgjithshëm të fëmijëve.

8. Infrastruktura

Sigurimi i hapësirës fizike: Në rastet kur nuk ka hapësirë fizike për veprimtarinë e fëmijëve, rekomandohet që bashkia të ketë si detyrim standardin për sigurimin e kësaj hapësire fizike (p.sh. marrja me qira e ndërtesave të reja).

9. Këshilli i Prindërve

Rekomandohet rritja e kapaciteteve të bashkisë për t'i përdorur Këshillat e Prindërve si një instrument gjithëpërfshirës për monitorimin e shërbimeve.

[8.6 Projekti; Situata ekonomike, strukturore dhe buxhetore të ndikuara nga pandemia COVID-19 për 13 bashki në Shqipëri](#)

Ky vlerësim u përgatit me bashkëpunimin e Ministrinë e Brendshme, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në kuadër të projektit të Prezencës së OSBE-së “Drejt politikave më gjithëpërfshirëse dhe efektive të qeverisjes vendore – Faza I”. Rezultatet e paraqitura në këtë studim janë si rrjedhojë e të dhënave të marra nga 13 bashkitë, analiza ekonomike, takimet e realizuara me përfaqësues të institucioneve kyçe dhe burimet e tjera të shprehura në metodologji.

Situata aktuale e pandemisë i ka vendosur Bashkitë përballë vështirësive të mëdha, të lidhura jo vetëm me shëndetin por edhe me menaxhimin e financave publike. Qeveria Shqiptare ka identifikuar nevojën për një analizë strukturore ekonomike dhe financiare mbi 13 Bashki në vend. Në kushtet kur financat publike rrezikohen, është shumë e rëndësishme për Bashkitë të kuptojnë kapacitetet e tyre financiare dhe të alokojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe adekuate burimet e tyre të kufizuara. Në këtë kontekst ky raport, jo vetëm ka analizuar impaktin ekonomik, financiar dhe buxhetor të COVID – 19 mbi këto Bashki, por ka identifikuar dhe vlerësuar mekanizmat e këtyre Bashkive për tu përballur me situatën dhe efektet afatgjata strukturore që priten të materializohen në të ardhmen e afërt.

Përhapja masive e pandemisë COVID-19, e cila vazhdon të ndikojë bizneset, individët dhe komunitetet urbane dhe rurale, ka ekspozuar shumë njësitë e qeverisjes vendore (më tej “Bashkitë”, “NJQV”) ndaj sfidave të mëdha, të materializuara në probleme të shëndetit publik, probleme sociale dhe pengesa të mëdha ekonomike dhe financiare. Vendimet drastike, si mbyllja e plotë e disa bizneseve dhe kufizimi kohor i veprimtarisë së disa bizneseve të tjera, me qëllim inkurajimin e distancimit fizik, ndihmuan në zbutjen e kurbës së infektiveve, por goditën rëndë performancën financiare të bashkive në Shqipëri.

Qeveria Shqiptare ka identifikuar nevojën për një analizë strukturore ekonomike dhe financiare mbi 13 bashki në vend. Në kushtet kur financat publike rrezikohen, është shumë e rëndësishme

për bashkitë të kuptojnë kapacitetet e tyre financiare dhe të rishpërndajnë në mënyrë të përgjegjshme dhe të përshtatshme burimet e tyre të kufizuara.

Në këtë kontekst, ky raport, jo vetëm do të analizojë ndikimin ekonomik, financiar dhe buxhetor të COVID – 19 mbi këto bashki, por do të identifikojë dhe vlerësojë mekanizmat e këtyre bashkive për t`u përballur me situatën dhe efektet afatgjata strukturore që priten të materializohen në të ardhmen e afërt.

Ky raport diagnostikues fokusohet në analizimin e situatës ekonomike, financiare dhe implikimet buxhetore strukturore që pandemia COVID-19 pati dhe po vazhdon të ketë mbi bashkitë në Shqipëri. Bashkitë e zgjedhura në këtë raport përbëjnë rreth 17% të popullsisë së Shqipërisë (387,779 banorë) dhe shtrihen në një sipërfaqe prej 7,152 km² (rreth 25% të sipërfaqes totale të vendit). Të gjitha bashkitë e zgjedhura kanë në përbërje 99 njësi administrative.

Përgjatë fillimit të vitit 2020, pandemia e COVID – 19 u përhap globalisht. Që prej fillimit, pasojat e pandemisë kanë ndikuar negativisht, në shkallë të ndryshme, kërkesë-ofertën për shërbime parësore qeveritare qoftë në nivel qendror dhe atë vendor, në kushtet kur pothuajse të gjitha institucionet publike kanë punuar me kufizime kohore dhe lëvizja e lirë e qytetarëve u pengua në kuadër të distancimit fizik dhe zbutjes së kurbës së infektiveve. Si një nga vendet e prekura, në muajin mars, Qeveria Shqiptare ndërmori masa drastike, duke pezulluar të gjithë aktivitetet jo parësore. Në kushtet e emergjencës, qeveria rishpërndau buxhetin e saj drejt financimit më të gjerë të sektorit të shëndetësisë, sektorit të mbrojtjes (specifikisht drejt menaxhimit të katastrofave natyrore) dhe gjithashtu, drejt Fondit Qeveritar Rezervë.

Në funksion të vlerësimit të impaktit ekonomik, financiar dhe strukturor të pandemisë mbi financat e bashkive të përzgjedhura, metodologjia e adoptuar mbështetet në tre faza kryesore duke përfshirë: i) analizimin e treguesve financiarë të bashkive përgjatë periudhës 2017-6M2020, ii) analizimin e përgjigjeve dhe informacionit cilësor dhe sasior të marrë nga bashkitë mbi pyetëtorin e dërguar tek ta, iii) dhe vlerësimin e informacionit të marrë gjatë takimeve me palë interesi të ndryshme, takime të cilat u ndihmuan të realizohen nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e vetëqeverisjes Vendore.

Bazuar në analizat financiare të treguesve për secilën nga 13 bashkitë, gjetjet kryesore të ndikimit të pandemisë COVID-19, përmbledhen si më poshtë.

1. Të ardhurat

- 10 nga 13 bashkitë e zgjedhura për këtë analizë reflektuan rënie të të ardhurave të veta në 6 mujorin e parë të 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019. Rënia e reflektuar në të ardhurat e veta të bashkive luhatet në intervalin 1% - 55%;
- Për periudhën e 6 mujorit të parë 2019 krahasuar me 6 mujorin e parë 2020, të gjitha bashkitë e analizuar përfituan më shumë nga transfertat e pakushtëzuara, me këto të fundit që u rritën mesatarisht 3% për të gjitha bashkitë; dhe
- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore u reduktuan në 6 mujorin e parë të 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019, për 11 nga 13 bashki, ndërkohë taksa mbi pasurinë u zvogëluar në 6 mujorin e parë të 2020 vetëm në 5 nga 13 bashki. Mbledhja e taksave nga biznesi i vogël u zvogëluar vetëm në 8 nga 13 bashki, për periudhën e 6 mujorit të parë 2019 krahasuar me 6 mujorin e parë 2020, ndërkohë të ardhurat jo-tatimore, u mblodhën më pak vetëm në 6 nga 13 bashki, për të njëjtën periudhë.

2. *Shpenzimet*

- 10 nga 13 bashkitë e zgjedhura për këtë analizë reflektuan rënie të shpenzimeve kapitale në 6 mujorin e parë të 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019;
- Për 7 nga 13 bashkitë e zgjedhura, shpenzimet korrente u reduktuan në 6 mujorin e parë të 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019; dhe
- Vetëm 1 nga 13 bashkitë e zgjedhura për analizë arriti të reduktonte shpenzimet operative dhe shpenzimet për personel në 6 mujorin e parë të 2020. Ndërkohë, 4 nga 13 bashki arritën të reduktojnë shpenzimet për personel për 6 mujorin e parë të vitit 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019.

Bazuar në analizën e përgjigjeve dhe informacionit të marrë nga pyetësorët e dërguar tek bashkitë, gjetjet kryesore të impaktit të pandemisë COVID-19 përmbledhen si më poshtë.

Nga 13 bashki, vetëm 12 bashki mundësuan përgjigje dhe informacion rreth pyetësorit të dërguar.

- Të ardhurat totale u reduktuan në gjysmën e parë të vitit 2020 me më shumë se 10% krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019, në 11 nga 12 bashki;
- Shpenzimet totale të bashkisë nuk u rritën në gjysmën e parë të vitit 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019 për asnjë nga 12 bashkitë;
- Për të përballuar problemet e shkaktuara të pandemisë, të gjitha bashkitë kanë rishperndarë burimet e veta;
- Vetëm 4 nga 12 bashkitë që kanë dhënë përgjigje për pyetësorin kanë reduktuar shpenzimet kapitale në 6 mujorit të parë të 2020;
- Vetëm 1 nga 12 bashkitë (Bashkia Skrapar) ka bërë rishikime për të ardhurat dhe shpenzimet për gjysmën e dytë të vitit 2020;
- Në raste emergjence, për të ruajtur balancat financiare, të gjitha bashkitë, sipas planit operacional të tyre, kanë reduktuar shpenzimet operative dhe shpenzimet për personel;
- Për të ndihmuar individët dhe bizneset e prekur nga pandemia, të gjitha bashkitë kanë implementuar eliminim të penaliteteve dhe shtyrje të taksave dhe tarifave; dhe
- Vetëm 1 nga 12 bashkitë përdor më shumë se 1 skenar për të buxhetuar të ardhurat dhe shpenzimet.
-

8.7 Konkursi i Praktikavete Mira

KPM-ja është një instrument që mundëson shkëmbimin e informacionit nga bashkitë mbi praktikat dhe nismat e tyre në fusha të ndryshme të administrimit dhe menaxhimit të funksioneve të vetëqeverisjes vendore në kuadrin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) dhe politikave sektoriale. KPM 2020 është event i dytë që drejtohet nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) dhe mbështetet nga “Bashki të Forta” (BtF) - një projekt i financuar nga SDC-ja dhe i zbatuar nga Helvetas-i. KPM 2020 zbatohet gjatë periudhës qershor - dhjetor 2020.

Në eventin KPM 2020, kanë marrë pjesë 38 bashki me 64 aplikime në katër kategoritë e veprimtarisë: (i) administrimi i arsimit parashkollor (kopshtet), (ii) administrimi i menaxhimit të mbetjeve urbane, (iii) administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes civile, (iv) demokracia vendore - veprimtaria dhe roli mbikëqyrës i organit përfaqësues të NJVQV-së (Këshilli bashkiak).

1. **Administrimi i arsimit parashkollor (kopshtet)**

Shqipëria vazhdon të harmonizojë legjislacionin e saj me kërkesat e BE-së në një numër fushash, duke rritur aftësinë e saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Vendi është

relativisht i përgatitur në shumë fusha, të tilla si kontrolli financiar, arsimit dhe kultura, si edhe statistikat.

Në nivel kombëtar, legjislacioni për sektorin e arsimit parauniversitar dhe arsimin parashkollor u zhvillua më tej me një ndikim në arsimin parashkollor dhe fëmijët/nxënësit nga kategoritë e margjinalizuara, duke përfshirë (i) Hartimin e programit mësimor të anglishtes për klasat përgatitore i cili po pilotohet në vitin shkollor 2020-2021; (ii) Miratimin e programit mësimor të anglishtes për klasat përgatitore; (iii) Përcaktimin e standardeve të zhvillimit dhe të të nxënësve për grupmoshën 0-3 vjeç ; standardet janë shpërndarë në të gjitha bashkitë.

Progres është bërë në drejtim të zbatimit të masave të Planit të Veprimit (PV) të SNDQV-së, veçanërisht në përgatitjen e Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për Normat e Punës Mësimore , si edhe Udhëzimet për Procedurat e Pranimit të Emërimit të mësuesve, edukatoreve (kopshte) në një vend të lirë pune. PV C.1.11 - Konsiderimi i mundësisë të financimit të një programi universal / kombëtar për ofrimin e ushqimit në arsimin parashkollor për të përmirësuar cilësinë dhe aksesin në kopshte, për të zbutur varfërinë dhe për të rritur përfshirjen dhe kohezionin social; PV C.1.11, pika e - Planet për Arsimin Parashkollor; Ligji Nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” për fondin e pagave për edukatorët.

Bashkitë pjesëmarrëse, në KPM 2020, nëpërmjet aplikimeve të tyre (18 gjithsej), treguan progres drejt zbatimit të disa masave të PV të SNDQV, të lidhura veçanërisht me:

1. Rritjen e aksesit në shkolla dhe investime për infrastrukturën arsimore, duke përfshirë rindërtimin/ rikonstruksionin e kopshteve dhe mbështetjen e gjithëpërfshirjes si një çështje kryesore e politikës në ndjekjen e qëllimeve kombëtare (ref. C.1.11, pika). Efikasiteti i shërbimit parashkollor është rritur (më shumë fëmijë të grupmoshës 3-5 vjeç të regjistruar në kopshte).
2. Ekzistojnë politikat vendore për zhvillimin e shërbimeve publike rreth nevojave të përdoruesve (Planet e Përgjithshme Territoriale, Planet Vendore të Investimeve, Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane). Nuk ka informacion të disponueshëm nëse Plani Vendor për Menaxhimin e Arsimit Parashkollor ekziston ose është në proces hartimi (C.1.1. Pika e – Hartimi i Planeve për Menaxhimin e Arsimit Parashkollor).
3. Bashkitë i kanë kushtuar vëmendje përmirësimit të infrastrukturës së kopshteve sipas standardeve kombëtare dhe rritjes së aksesit të fëmijëve me aftësi të kufizuara (PV C.1.11 - standardet).
4. Janë futur instrumente inovative në administrimin e sistemit parashkollor, të tilla si dixhitalizimi dhe hartëzimi i ndërtesave parashkollore, mësimdhënia online, shërbimet në internet të ofruara nga psikologët në situatën pandemike. Objektivat e programeve mësimore janë arritur përmes mësimdhënies online; edukatorët e kopshteve hapën skedarë "virtualë" për secilin fëmijë dhe kanë monitoruar rregullisht progresin e tyre (PV C.1.11 – Rritja e eficiencës të shërbimit /përmirësimi i efektivitetit të shërbimit).
5. Përmirësimi i standardeve të shërbimit: Forcimi i kapaciteteve administrative të bashkive duke ngritur struktura të reja të dedikuara për sektorin e arsimit parashkollor, rritje të numrit të mësuesve mbështetës dhe psikologëve (standard i shërbimit), trajnim i rregullt për mësuesit e sistemit parashkollor (PV C.1.11 – Rritja e eficiencës të shërbimit /përmirësimi i efektivitetit të shërbimit, rritja e cilësisë kundrejt standarteve të edukimit (reference objektivi i SZHAPU)).
6. Arsimit gjithëpërfshirës: Shërbimet sociale janë ofruar nga qendra të komunitetit për familjet në nevojë dhe familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara. Praktikantët e ofruara nga bashkitë kanë treguar një mundësi të shtuar të shërbimeve dhe efektivitet në marrjen e

rezultateve më të mira në ofrimin e shërbimeve në përgjithësi dhe në veçanti për pakicat kombëtare sipas ligjit dhe fëmijët me aftësi ndryshe.

7. Përmirësimi i sistemit të raportimit – shkëmbimi i të dhënave midis Bashkive, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë/ Institucionit Arsimor Vendor dhe NJVQV-ve, për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkolla (PV C.1.11, pika b - Krijimi i një sistemi të ndërsjellë shkëmbimi të dhënash midis MASR/Institucioni Arsimor Vendor, MFE dhe NJVV-ve, mbi regjistrimin dhe frekuentimin e fëmijëve në kopshte e nxënësve në shkolla)
8. Futja e instrumenteve inovative për ofrimin e shërbimeve duke mundësuar sigurimin e programeve arsimore në internet gjatë situatës pandemike (C1.11 Rritja e efikasitetit për ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit).

Progresi më i vogël është arritur në aspekte të tjera, të tilla si niveli i financimit të sektorit (si % e PBBsë), zhvillimi i mëtejshëm i programeve të edukimit në fëmijërinë e hershme për të arritur objektivat e përcaktuara në SZHAPU dhe SKZHI II, 2014-2020, dhe përmirësimi i aspekteve cilësore të arsimit .

2. Administrimi dhe Menaxhimi i Mbetjeve (Mjedisi)

Qeveria e Shqipërisë ka hartuar dhe miratuar dokumentin strategjik "Për Planin Kombëtar Sektorial të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve" (2020) në lidhje me ndërtimin e infrastrukturës, për përcaktimin e menaxhimit rajonal të mbetjeve, përcaktimin e zonave të integruara të menaxhimit të mbetjeve, si dhe përcaktimin e kostove të investimit dhe kostove operacionale; dokumenti strategjik përcakton 10 zona për menaxhimin e integruar të mbetjeve (ZMM). Dy studime të fizibilitetit për ZMM në Kukës dhe Berat kanë përfunduar dhe pritet të financohet ndërtimi i tyre. Që nga viti 2018, është ngritur Agjencia e Ujësjetësimit, Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve. Ndër detyrat e tjera, kjo Agjenci siguron mbështetje dhe asistencë teknike për bashkitë në lidhje me përmirësimin e funksionit të menaxhimit të mbetjeve urbane.

Megjithëse ekziston njëfarë niveli i përgatitjes për harmonizimin e politikave dhe legjislacionit me acquis, ende duhen bërë përpjekje të rëndësishme për zbatimin dhe kontrollin e zbatueshmërisë së legjislacionit kombëtar veçanërisht për menaxhimin e mbetjeve urbane, cilësinë e ujit dhe ajrit dhe ndryshimin e klimës.

Aplikimet për praktikën e mira nga 10 bashki, në kuadrin e edicionit KPM 2020, treguan progres drejt arritjes së objektivit specifik (C1.4) dhe masave të Planit të Veprimit 2020-2022 të SNDQV-së:

1. Hartimi dhe miratimi i planeve vendore për menaxhimin e mbetjeve në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Planet Vendore Menaxhimin e Mbetjeve (PVMM) janë hartuar me mbështetjen e institucioneve qëndrore dhe projekteve të financuara nga donatorët. PVMM-të miratohen me vendim të Këshillave Bashkiakë. (progresi lidhur me PV C.1.4- Rritja e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, pika b-Hartimi i studimeve / planeve me qëllim zbatimin e objektivave të përcaktuara në dokumentat strategjike në fushën e mbetjeve)
2. Është përmirësuar depozitimi i mbetjeve në landfill; grumbullimi i diferencuar i mbetjeve në burim pilotohet në disa zona të pilot sipas PVMM-ve. (PV C1.4, pika dh10)
3. Qeverisja e mirë në nivel vendor: Janë organizuar konsultime me qytetarët dhe grupet e interesit përfshirë komunitetin e biznesit, shoqërinë civile, grupet vulnerabël në lidhje me objektivat për shërbimin e mbetjeve urbane, tarifën e re të shërbimit dhe ndryshimin progresiv të saj për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane kundrejt standardeve të përballeshme; PVMM-të publikohen në faqen zyrtare të bashkive (ëbsite). Pavarësisht progresit të bërë për përmirësimin e administrimit të të ardhurave nga tarifa e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, mbetet ende një sfidë

rritja e buxhetit vendor për shërbimin dhe e tarifës së shërbimit me 2.5 herë deri në vitin 2030 për mbulimin e kostos dhe cilësisë së shërbimit.

4. Rikualifikimi i depozitimeve të paautorizuara të mbetjeve dhe kthimi në një hapësirë të gjelbër. (C1.4, pika d- Vlerësim dhe shqyrtim i planeve të përmirësimit nga institucionet përgjegjës të përcaktuar në VKM nr. 452, datë 11.7.2012, "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar)
5. Është përmirësuar kapaciteti administrativ dhe monitorues për shërbimin e mbetjeve urbane (PV C.1.4- Rritja e cilësisë dhe eficiencës së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve): o Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve është rritur nga rreth 70% në vitin 2018 në 90% në vitin 2020. o Është rritur administrimi i të ardhurave nga mbledhja e tarifave. o Është përmirësuar kapaciteti i monitorimit dhe raportimi nga Bashkitë mbi shërbimin dhe zbatimin e kontratave të shërbimeve të lidhura me subjektet private të kontraktuara (shërbimi i nënkontraktuar).
6. Bashkitë kanë zbatuar regjimin e ndëshkimit për gjobitjen e banorëve dhe bizneseve që krijojnë probleme mjedisore dhe nuk respektojnë rregullat.
7. Në disa bashki është zbatuar një qasje e re: grumbullimi i mbetjeve kryhet derë më derë për të gjitha bizneset në periudhën dhe zonën turistike.

3. Administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes civile në nivel vendor

Është bërë progres lidhur me objektivin PV C1.9 - Mbështetje për NJVQV-të për të ushtruar funksionin në lidhje me sigurinë publike, pika a. Programi për mbështetjen e MZSH në nivel vendor, dhe pika b. Qartësimi i rregullimit të funksionit MZSH vendore: (i) Është përmirësuar baza rregullatore për klasifikimin e objekteve sipas rrezikut nga zjarri, procedurat që duhet të zbatohen nga NJVQV-të për rishikimin dhe miratimin e mbrojtjes nga zjarri dhe lëshimin e çertifikate të sigurisë nga zjarri (Urdhër i Ministrit të Brendshëm, Nr. 81, datë 6.03.2020); është hartuar dhe miratuar formulari i vlerësimit për projektin për mbrojtjen nga zjarri, (ii) Modeli tip i kërkesës për Çertifikatë për mbrojtje nga zjarri, (iii) Procedura e përcaktuar para se Bashkia të marrë në zotërim një objekt., (iv) Modeli (projekti) i përgatitur nga MZSH12 duke përcaktuar (1) Sistemet dhe pajisjet e diktimit dhe sinjalizimit të zjarrit, (2) mjetet dhe pajisjet, (3) Skema e evakuimit të detyrueshëm të punonjësve në rast zjarri, dhe (v) Modeli tip i raportit teknik për NJVQV-të që përcaktojnë nivelin e rrezikut, shkallën e rezistencës ndaj zjarrit të ndërtesës, normat e kërkuara për diktimin e zjarrit, sinjalizimin, evakuimin.

Sa i takon masës të PV C.3.2-Hartimi dhe përditësimi i standardeve minimale kombëtare për Emergjencat Civile, parashikohet se aktet nënligjore të Ligjit 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" do të hartohen dhe miratohen në vitin 2021. Aktet n. ligjore dhe rregulloret e reja do të sigurojnë standardet e këtij funksioni në nivel qendror, rajonal dhe vendor, duke përfshirë modelin tip dhe kërkesat për dokumentin e vlerësimit të rrezikut, planin e emergjencës në nivel vendor, modelin organizativ të komunitetit dhe grupet vullnetare¹³ si edhe standarde të tjera.

Pavarësisht se standardet dhe aktet nënligjore të Ligjit 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" mungojnë, bashkitë kanë bërë përpjekje për të përditësuar Planin Vendor për Emergjencat Civile pas RAT-it; këto plane vendore janë harmonizuar me Planin Kombëtar ekzistues. Janë arritur rezultatet e mëposhtme:

1. Planet për Mbrojtjen Civile në nivel qendror, rajonal dhe vendor janë harmonizuar me Planin Kombëtar të vitit 2004.
2. Rreth 38% 14 e bashkive kanë planin e përditësuar vendor të emergjencave për territorin e tyre të ri pas Reformës Administrative dhe Territoriale, ndërsa bashkitë e tjera po punojnë për planin e ri (të përditësuar) të emergjencave vendore.

3. Ndërtimi i kapaciteteve është mundësuar për punonjësit në nivel vendor, rajonal dhe qendror në zbatimin e Planeve të Mbrojtjes Civile¹⁵: o Zhvillimi i trajnimeve për punonjësit vendorë në fushën e Mbrojtjes Civile. o Zhvillimi i veprimtarive për informim dhe ndërgjegjësim mbi rreziqet dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore.
4. Përgatitja e hartave të rrezikut në nivel vendor, rajonal dhe qendror dhe shkëmbimi i informacionit¹⁶.
5. 89% e bashkive kanë ngritur strukturën për mbrojtjen civile të përbërë nga policia bashkiake, shërbimi i zjarrfikësve dhe shpëtimit dhe njësi e mbrojtjes civile.
6. 49% e bashkive kanë krijuar strukturën komunitare për situata emergjente.

4. Veprimtaria Vendimmarrëse dhe Mbikëqyrëse e Këshillit Bashkiak

Praktikat e mira treguan progres në disa fusha të veprimtarisë legislative të Këshillit Bashkiak në lidhje me zbatimin e PV 2020-2022 për SKNDQV-në, duke iu referuar posaçërisht forcimit të kapaciteteve vendimmarrëse dhe monitoruese të organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të kuadrit rregullator për veprimtarinë legislative dhe politikëbërjen e KB-ve (miratimi i rregulloreve të KB-ve), dhe qeverisjes së hapur, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në konsultimet publike dhe qeverisjes elektronike në nivel vendor.

Duke iu referuar masave të PV-së për reformën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore (SKNDQV), u bë progres në:

1. Përmirësimin e kuadrit rregullator për veprimtarinë legislative dhe politikëbërëse të Këshillit Bashkiak (PV A.1.2: Forcimi i kapaciteteve vendimmarrëse dhe monitoruese të organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore pika d - Hartimi i rregulloreve për Këshillat Bashkiakë): 6 rregullore miratohen nga KB-ja.
2. Është përmirësuar roli mbikëqyrës i KB-së në zbatimin e politikave sociale në nivel vendor. KB-të kanë inicuar krijimin e një grupi me pjesëmarrjen e komisionit të barazisë gjinore për të siguruar një rol mbikëqyrës dhe monitorimin e politikave sociale, specifikisht (i) monitorimin e planit vendor social, forcimin e kapacitetit administrativ të strukturës për mirëqenien sociale (plotësimi i vendeve vakante, caktimi i koordinatorëve vendorë kundër dhunës në familje, ngritja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, kryerja e vizitave në terren në familje ekonomisht të pafavorizuara, prioriteti i punësimit të grave viktime të dhunës në familje, ndërtimi i shtëpive sociale dhe masa të tjera, ofrimi i ndihmës për familjet dhe grupet më të cënueshme gjatë situatës pandemike (Covid -19), lidhur me zbatimin e PV A.1.2: Forcimi i kapaciteteve vendimmarrëse dhe monitoruese të organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore.
3. Janë futur metoda të reja dhe instrumente inovative për të rritur efektivitetin e veprimtarisë së KB-së në organizimin e dëgjësive publike për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit përmes platformës në internet, përdorimin e mediave sociale dhe faqen zyrtare të bashkisë për njoftimet publike dhe vendimmarrjen e KB, zhvillimi i platformës TIK (aplikacione online) për organizimin e mbledhjeve të KB-së gjatë situatës pandemike (PV D1.2- Përgatitja e një programi për rritjen e mundësisë të aksesit efektiv të qytetarëve në vendimmarrjen vendore dhe aktet normative vendore përmes botimit proaktiv dhe përdorimit të TIK , D1.3- Mbështetja e qeverisjes vendore për përdorimin e platformave të informacionit publik) .
4. Përmirësimi i metodologjisë dhe praktikave për format e konsultimit publik për aspektet e financave publike dhe qeverisjes, duke përfshirë konsultimin publik për buxhetin afatmesëm dhe buxhetin vjetor (PV D1.4)

Konkursi i Praktikave të Mira”, i cili është organizuar në datat: 25, 26, 27 Nëntor 2020, nga Ministria e Brendshme, AMVV me mbështetjen e Ambasadës Zviceriane nëpërmjet Projektit Bashki të Forta, ka përfunduar zhvillimin e Konkursit të Praktikave të Mira me ceremonine e

përmbylljes së datës 09.12.2020 dhe sipas vendimmarrjes së jurive u shpërndanë dhe çmimet si më poshtë:

1. Parashkollori: Korçë dhe Lezhë
2. Mbetjet Urbane: Lezhë dhe Has
3. Mbrojtje Civile: Tiranë dhe Shijak
4. Këshilli Bashkiak: Shkodër (çmim i plotë) dhe njëri prej çmimeve ndahet midis Delvinës dhe Skraparit
5. Çmimi i Publikut: Durrës, Shkodër, Shijak dhe Dibër.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Bekim MURATI

Aneks 1

Shkalla e zbatueshmërisë për Ministritë e Linjës

Institucioni	Numri i projektakteve	Shkalla e zbatimit (%)
Ministria e Brendshme	10	100.0%
Ministria e Mbrojtjes	1	100.0%
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	20	90.0%
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	5	100.0%
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	10	90.0%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	16	50.0%
Ministria e Kulturës	1 into 11	100.0%
Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale	9	100.0%
Total	71 into 82	730%
Mestare		91.3%



Zbatimi i
Urdhrit.xlsx

